

RAPORT ANALITIK

FORCIMI I ROLIT TË INSTITUCIONEVE MBIKËQYRËSE PËR LLOGARIDHËNIEN BUXHETORE NË NIVEL VENDOR



Funded by
the European Union

bat

Budget
Accountability
and Transparency

Autorja: Lorena Zajmi

2025

Botues: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Rr. Shenasi Dishnica,
Nd. 35, H. 1, 1017, Tirana, Albania P.O.Box 8177. Email: info@idmalbania.org
| Website: idmalbania.org

Riprodhimi i pjesëve të këtij botimi lejohet vetëm duke cituar burimin original.

Ky dokument është prodhuar në kuadër të nismës “BAT Civil Society”, e zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në të i përka-
sin vetëm autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrimet e Bashkimit Evropian.



Institute
for Democracy
and Mediation



Center for
Research and
Policy
Making

... policy impact since 2004



Fakt@je.al

PËRMBAJTJA

I. Hyrje	05
II. Kuari i Përgjithshëm: Qeverisja Vendore dhe Llogaridhënia në Shqipëri	06
III. Roli i Institucioneve Mbikëqyrëse në Nivel Vendor	08
IV. Sfidat Kryesore në Zbatimin e Llogaridhënies Buxhetore	19
V. Rekomandime për Përmirësimin e Llogaridhënies dhe Integritetit në Nivel Vendor	28
Aneksi 1. Të Dhëna Përmbledhëse mbi Auditimet e Performancës së Bashkive nga KLSH (2024–2025)	31

Ky dokument politikash analizon në mënyrë të thelluar mënyrën se si njësitë e qeverisjes vendore (NJQV) në Shqipëri i përgjigjen sfidave të llogaridhënies buxhetore, duke vlerësuar rolin që luajnë institucionet mbikëqyrëse si Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPI), njësitë e auditit të brendshëm, etj. Në një kontekst ku qeverisja vendore është përballur me decentralizim të kompetencave, por jo domosdoshmërisht me decentralizim të burimeve dhe kapaciteteve, mbikëqyrja efektive financiare dhe integriteti institucional përbëjnë sfida të vazhdueshme.

Përballë mungesës së të dhënave të plota dhe të rregullta mbi nivelin e korrupsionit në pushtetin vendor, NJQV përfaqësojnë hapësira me rrezik të lartë për shkelje në menaxhimin e fondeve publike, prokurimeve, pasurive publike dhe punësimeve. Pavarësisht ekzistencës së planeve të integritetit dhe përmirësimeve të pjesshme në auditimin e brendshëm, sfida si mungesa e kapaciteteve njerëzore, mbikëqyrja formale dhe raportimi joanalitik vazhdojnë të pengojnë ndërtimin e një sistemi funksional dhe të besueshëm të kontrollit të brendshëm dhe llogaridhënies.

Dokumenti trajton sfidat më të theksuara që përfshijnë mungesën e dokumentimit të auditimeve, proceset e prokurimeve të ekspozuara ndaj klientelizmit dhe mungesës së konkurrencës, mungesën e mekanizmave funksionalë për sinjalizimin e korrupsionit, si dhe shkeljet në rekrutimin e stafit në kundërshtim me normat e shërbimit civil. Në të njëjtën kohë, evidentohet se programet e transparencës nuk përkthehen realisht në akses të qytetarëve ndaj informacionit dhe mungojnë nisma të qëndrueshme për përfshirjen e komunitetit në monitorimin buxhetor.

Ky dokument ofron rekomandime për forcimin e kapaciteteve të NJQV në auditim dhe menaxhim financiar, institucionalizimin e planeve të integritetit me buxhet të dedikuar, promovimin e transparencës përmes teknologjisë dhe përfshirjen e shoqërisë civile dhe qytetarëve në mënyrë të qëndrueshme në proceset e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies. Duke u bazuar në gjetje konkrete dhe në përvojën e institucioneve vendore dhe organizatave të shoqërisë civile, ky dokument synon të shërbejë si një udhërrëfyes praktik për të gjitha NJQV që synojnë të ndërtojnë struktura të qëndrueshme dhe funksionale të mbikëqyrjes dhe integritetit, të afta për të garantuar një qeverisje vendore më të hapur, më të përgjegjshme dhe më rezistente ndaj korrupsionit.

I. Hyrje

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mbartin përgjegjësi të drejtpërdrejta në menaxhimin e financave publike, përfshirë hartimin e buxheteve lokale, mbledhjen e të ardhurave dhe realizimin e prokurimeve publike. Ato gjithashtu janë përgjegjëse për administrimin e pasurive publike dhe zhvillimin e sistemeve të auditimit të brendshëm. Megjithatë, në mungesë të mekanizmave të fuqishëm të mbikëqyrjes, këto funksione shpesh ushtrohen në mënyrë jo-efikase dhe jo transparente. Raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit (2022–2025) kanë evidencuar parregullsi në procedurat e prokurimit publik, mangësi në auditimin e brendshëm dhe shmangie nga praktikat e planifikimit financiar të bazuar në objektiva të matshëm. Në disa raste, këto shkelje kanë çuar në hetime penale nga SPAK për korrupsion dhe abuzim me detyrën në disa bashki, duke nxjerrë në pah dobësitë sistemike të sistemit të qeverisjes vendore.

Reforma administrativo-territoriale e vitit 2015 shënoi një pikë kthese në organizimin e pushtetit vendor në Shqipëri, duke reduktuar ndjeshëm numrin e njërive të vetëqeverisjes vendore nga 373 në 61 bashki. Megjithatë, ky proces ka sjellë sfida të shumta, duke përfshirë mungesën e burimeve të mjaftueshme financiare, kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore për të përmbushur funksionet e deleguara. Për më tepër, decentralizimi i kompetencave nuk është shoqëruar proporcionalisht me decentralizimin e burimeve financiare dhe përgjegjësi fiskale. Si rezultat, shumë bashki përballen me kufizime të theksuara buxhetore, mungesë të kapaciteteve teknike dhe vështirësi në përmbushjen e funksioneve të tyre të reja.

Të dhënat nga raporti i performancës së bashkive për vitin 2025 tregojnë progres të dukshëm në disa drejtime, të ardhurat e veta për frymë janë rritur me 166% që nga viti 2015, dhe investimet për frymë janë rritur me 78%, por gjithashtu nënvizojnë sfida të vazhdueshme në fushat e barazisë rajonale, realizimit të buxheteve, shërbimeve sociale dhe menaxhimit të infrastrukturës.¹ Pjesa më e madhe e bashkive të vogla mbetet ende e varur nga transfertat e pakushtëzuara nga qeveria qendrore, ndërsa pabarazitë në gjenerimin e të ardhurave janë të theksuara. Shkalla e transparencës dhe e llogaridhënies ka njohur përmirësime, megjithatë mbeten të nevojshme mekanizma më të fuqishëm për menaxhimin e të dhënave, planifikimin strategjik dhe monitorimin e performancës në nivel vendor.

Llogaridhënia buxhetore në nivel vendor është themeli i një qeverisjeje të përgjegjshme, transparente dhe të ndershme. Ajo siguron që fondet publike të përdoren në mënyrë efektive, në përputhje me ligjin dhe në interes të qytetarëve. Në një kontekst me rrezik të lartë për korrupsion, siç është pushteti vendor në Shqipëri, mungesa e mbikëqyrjes efektive financiare mund të çojë në abuzime me fonde publike, punësime klienteliste, shkelje të procedurave të prokurimit dhe keqadministrim të pasurive publike.

II. Kuadri i Përgjithshëm: Qeverisja Vendore dhe Llogaridhënia në Shqipëri

Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” përcakton ministritë, sipas fushave të përgjegjësisë, si dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit si organet përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë të njësive të vetëqeverisjes vendore.² Krahas tij, një sërë ligjesh të tjera përbëjnë bazën e funksionimit të pushtetit vendor në Shqipëri. Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” përcakton mekanizmat e financimit dhe marrëdhëniet fiskale ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore.³ Ndërkohë, Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” synon profesionalizimin e administratës publike edhe në nivel vendor.⁴ Ligji nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”⁵ dhe Ligji nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”⁶ përbëjnë shtylla të rëndësishme për ndërtimin e integritetit institucional dhe etikës në administrimin publik. Në përputhje me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore, Shqipëria ka miratuar një sërë masash ligjore për t’i dhënë pushtetit vendor kompetenca të gjera në fushat e infrastrukturës, shërbimeve sociale, edukimit parashkollor dhe zhvillimit lokal.⁷ Megjithatë, këto kompetenca nuk janë shoqëruar në mënyrë të barabartë me alokimin e burimeve financiare dhe teknike për realizimin e tyre.

Pavarësisht progresit në ndërtimin e kuadrit ligjor për vetëqeverisjen vendore në Shqipëri, zbatimin në praktikë mbetet i mangët, veçanërisht në aspektin e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies buxhetore. Institucionet vendore përballen me pabarazi të theksuara në kapacitetet fiskale, me dallime të mëdha në të ardhurat për frymë ndërmjet bashkive, të cilat mekanizmat aktualë të barazimit nuk arrijnë t’i zbusin në mënyrë efektive.⁸ Si rrjedhojë, ofrimi i shërbimeve publike është i pabarabartë dhe i fragmentuar. Në fund të vitit 2024, stoku i detyrimeve të prapambetura të bashkive rezultoi në rreth 3.2 miliard lekë, duke shënuar një ulje të konsiderueshme prej 1.6 miliard lekësh krahasuar me fundin e vitit 2023.⁹ Kjo tendencë reflekton një përmirësim të ndjeshëm në menaxhimin financiar të njësive të vetëqeverisjes vendore. Ndërsa në vitin 2023 mbi 85% e bashkive raportonin detyrime të prapambetura, në disa raste borxhi i akumuluar tejkalonte të ardhurat vjetore,¹⁰ në vitin 2024 detyrimet e prapambetura përbënin vetëm 4.3% të totalit të shpenzimeve faktike të pushtetit vendor.¹¹

Gjithashtu, NJQV-të përballen me pabarazi të theksuara në shpërndarjen e të ardhurave dhe transfertave nga qeveria qendrore. Njësitë e qeverisjes vendore më të mëdha urbane

përfitojnë pjesën më të madhe të fondeve, ndërsa bashkitë më të vogla (zonat rurale) mbeten të nënpajisura për të ofruar shërbime të njëjta cilësore.¹² Megjithëse ekziston bashkërendim formal midis niveleve të qeverisjes, besimi i publikut ndaj autoriteteve vendore mbetet i ulët dhe mekanizmat e barazimit financiar nuk kanë qenë efektivë në adresimin e pabarazive në ofrimin e shërbimeve.¹³

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2024) thekson se ndarja e qartë e funksioneve ndërmjet nivelit qendror dhe vendor mungon, ndërsa njësitë e vetëqeverisjes vendore përballen me burimet të pamjaftueshme financiare dhe kapacitete të kufizuara administrative. Autonomia fiskale mbetet e rrezikuar, cilësia e shërbimeve publike e ulët dhe mekanizmat e llogaridhënies në raport me qytetarët të dobët.¹⁴

Megjithëse kuadri strategjik kombëtar për integrimin evropian dhe decentralizimin¹⁵ është miratuar dhe në 60 bashki janë krijuar njësi të menaxhimit të performancës, vetëqeverisja vendore mbetet e varur financiarisht nga transfertat e qeverisë qendrore dhe ka mungesë kapacitetesh për buxhetim të bazuar në performancë. Përgjatë viteve të fundit janë vërejtur përmirësime të moderuara në digjitalizimin e shërbimeve dhe transparencën fiskale (si ligji për të dhënat e hapura, rritja e publikimit të programeve të transparencës), ndërsa indeksi i integritetit është zbatuar në 23 bashki. Stafet vendore kanë marrë trajnim më të madh, por rotacioni i lartë i personelit dhe përdorimi ende i pjesshëm i Sistemit Informatik për

Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ - HRMIS) pengojnë profesionalizmin afatgjatë.¹⁶

Financiarisht, të ardhurat vendore dhe ulja e detyrimeve të prapambetura kanë treguar progres, por diversifikimi i burimeve dhe harmonizimi i procedurave buxhetore mbeten prioritet. Në aspektin ekonomik, vetëm një pjesë e bashkive kanë plane zhvillimi strategjik, duke kufizuar potencialin e tyre për rritje dhe shfrytëzim fondesh të BE-së. Përshpejtimi i reformave në menaxhimin financiar, fuqizimi i mekanizmave të mbikëqyrjes dhe integrimi real i standardeve të BE-së janë thelbësore për forcimin e llogaridhënies buxhetore në nivel vendor. Përdorimi i instrumenteve të vetë-financimit mbetet i kufizuar. Tatimet dhe tarifat vendore, të cilat duhej të përbënin një burim të qëndrueshëm për NJQV-të, shpesh nuk administrohen në mënyrë efikase për shkak të kapaciteteve të dobëta administrative dhe mungesës së teknologjisë digjitale.¹⁷

Të dhënat me vlerë të lartë publike—si financat publike, transaksionet buxhetore dhe vendimet gjyqësore—janë ende të aksesueshme vetëm pjesërisht në nivel vendor dhe kërkojnë aftësi të avancuara për t'u analizuar. Edhe pse platformat e të dhënave të hapura nuk vendosin kufizime në akses, ekzistojnë shqetësime lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Koncepti i të dhënave të hapura ka nisur të marrë vëmendje globale pas themelimit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP) në vitin 2011. Shqipëria është pjesë e këtij partneriteti, por në nivel vendor vetëm Bashkia Elbasan dhe Bashkia Tiranë janë përfshirë në këtë nismë,

duke reflektuar angazhim të kufizuar të qeverisjes vendore në promovimin e transparencës dhe llogaridhënies përmes të dhënave të hapura.¹⁸

Në përgjithësi, kjo situatë thekson nevojën për forcimin e mëtejshëm të institucioneve të mbikëqyrjes dhe auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, përfshirë rritjen e transparencës, përmirësimin e mekanizmave të raportimit financiar dhe monitorimit të financave publike të pushtetit vendor.

III. Roli i Institucioneve Mbikëqyrëse në Nivel Vendor

Institucionet mbikëqyrëse në nivel vendor në Shqipëri luajnë një rol thelbësor në monitorimin, mbështetjen dhe vlerësimin e performancës së njësive të vetëqeverisjes vendore si dhe në garantimin e integritetit, transparencës dhe përdorimit të ligjshëm të burimeve publike.

MINISTRI I SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor është autoriteti koordinues për çështjet e decentralizimit dhe zhvillimit të qeverisjes vendore.¹⁹ Ai ka rol mbikëqyrës dhe promovues për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për

Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030,²⁰ si dhe për sigurimin e mbështetjes teknike dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale të NJQV-ve. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) është institucioni qendror që mbështet ministrinë përgjegjëse për pushtetin vendor në çështjet e decentralizimit dhe funksionimin e bashkive.²¹ Ajo monitoron zbatimin e Strategjisë për Decentralizimin, ofron këshillim teknik dhe ligjor për njësitë vendore, mbledh dhe analizon të dhëna mbi performancën e tyre, si dhe promovon praktika të mira në qeverisjen vendore. AMVV luan gjithashtu rol ndërmjetësues mes qeverisë qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, duke ndihmuar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe koordinimin institucional.

Megjithatë, kapacitetet funksionale të agjencisë për çështjet e qeverisjes vendore në Shqipëri mbeten të kufizuara. Roli i saj është ende i fragmentuar për sa i përket kompetencave reale mbikëqyrëse dhe kapaciteteve për të ndikuar në performancën financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore. Shqipëria shënon përqindje të ulët të të ardhurave vendore në raport me PBB-në (vetëm 3.8%) dhe me të ardhurat publike totale (13.8%), duke reflektuar një decentralizim fiskal të limituar. Struktura e të ardhurave vendore dominohet nga transfertat e përgjithshme dhe grantet e investimeve, ndërsa burimet e veta përbëjnë vetëm 39% të totalit, duke e bërë varësinë nga qeveria qendrore të ndjeshme dhe të vazhdueshme.²² Në të njëjtën kohë, reforma e decentralizimit e vitit 2015 nuk është pasuar nga një reformë e sistemit tatimor dhe fiskal për të kaluar drejt një skeme të ndarjes së të ardhurave midis pushtetit vendor dhe atij qendror, e cila të jetë më e drejtë dhe të garantojë kalimin e fondeve drejt pushtetit vendor jo më në formën e granteve, por si të ardhura të mirëfillta të veta.²³ Për më tepër, kapacitetet për të ndërmjetësuar dhe lehtësuar zbatimin e reformave në nivel lokal mbeten të pamjaftueshme, shpesh të varura nga asistenca e projekteve të përkohshme të donatorëve ndërkombëtarë. Në vitin 2024, buxheti i shtetit alokoi rreth 43.1 miliardë lekë për pushtetin vendor, një rritje prej 17.1% krahasuar me vitin e kaluar. Ndërkohë nga viti 2014, të ardhurat e veta të bashkive janë rritur me 360%, ndërsa detyrimet e prapambetura janë ulur nga 12.1 miliardë lekë në 4.9 miliardë lekë. Po ashtu, është ngritur Akademia e Pushtetit Vendor për të trajnuar

stafin e njësive vendore në përputhje me kërkesat e acquis të BE-së.²⁴

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) gjithashtu kontribuon në përmirësimin e integritetit dhe qeverisjes lokale përmes hartimit, zbatimit dhe monitorimit të Planeve të Integritetit. Deri më sot, AMVV ka ndihmuar 35 bashki në hartimin e këtyre planeve, duke finalizuar edhe procesin e monitorimit për 17 prej tyre në vitin 2024. Me një normë mesatare zbatimi prej 59%, progresi është i dukshëm, por nënvizon domosdoshmërinë për rritjen e kapaciteteve dhe angazhimit të strukturave vendore në zbatimin efektiv të masave kundër korrupsionit dhe në rritjen e transparencës së menaxhimit të fondeve publike.²⁵

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT (KLSH)

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni suprem i auditimit të jashtëm në Shqipëri, i parashikuar nga neni 162 i Kushtetutës dhe i rregulluar me Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”²⁷. Ai ka mandat për të realizuar auditime të pavarura mbi përdorimin e fondeve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes, përfshirë njësitë e qeverisjes vendore. Auditimet e KLSH tashmë përfshijnë si komponentin financiar ashtu edhe atë të performancës, duke u zhvilluar në përputhje me standardet e Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Objektivat e institucionit janë përqendruar gjithnjë e më shumë te vlerësimi i menaxhimit të fondeve

publike dhe performancës në administrimin lokal.²⁸ Në korrik 2024, Kuvendi miratoi ngritjen e një nënkomisioni të posaçëm nën Komisionin për Ekonominë dhe Financat, “Nënkomisioni për Auditimin e Sektorit Publik” për ndjekjen e rekomandimeve të KLSH-së dhe forcimin e dialogut institucional.²⁹

Megjithatë, kapacitetet ekzistuese të institucionit janë të pamjaftueshme për të mbuluar 61 bashkitë në mënyrë sistematike dhe të thelluar, auditimet shpesh kryhen me vonesë ose janë të pjesshme, duke reflektuar kufizimet në burimet njerëzore dhe financiare.³⁰ KLSH-ja gjatë vitit 2023 ka adresuar për institucionet publike të audituara 5759 rekomandime, ku rezulton se pothuajse 50% e rekomandimeve janë dhënë nga Departamenti i Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, për të cilat KLSH-ja ka rekomanduar numrin më të madh të masave organizative janë Bashkia e Vlorës me 74 masa, Bashkia e Fierit me 51 masa, Bashkia e Pogradecit me 49 masa dhe Bashkia e Beratit me 45 masa. Bashkia e Vlorës ka edhe numrin më të lartë të masave disiplinore dhe administrative të dhëna për auditimin, me 58 masa.³¹

Sipas Raportit Vjetor të Performancës për vitin 2024, KLSH ka realizuar 159 misione auditimi në 205 subjekte publike, nga të cilat 75 i përkasin njësisë të vetëqeverisjes vendore. Pavarësisht kësaj përpjekjeje, numri relativisht i ulët i auditimeve të performancës (vetëm 15 në total) dhe përqindja ende jo e plotë e zbatimit të rekomandimeve (rreth 70%) dëshmojnë se sfidat mbeten prezente, sidomos

në drejtim të ndjekjes efektive të rekomandimeve nga institucionet vendore. Edhe pse niveli i pranueshmërisë së rekomandimeve mbetet i lartë (99%), zbatueshmëria e tyre tregon për nevojën e forcimit të mekanizmave të brendshëm menaxherialë dhe vendimmarrës në nivel vendor.³²

Bazuar në auditimet e ushtruara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në vitet 2024 dhe 2025 në njësitë e qeverisjes vendore dhe prefektura, rezulton një gjendje shqetësuese në administrimin financiar vendor. Problematikat e evidentuara përfshijnë një spektër të gjerë që variojnë nga shkelje në prokurimet publike, mosarkëtim të të ardhurave, mbivlerësime kontabël, mungesë të kontrollit të brendshëm, deri te moszbatimi i rekomandimeve të mëparshme të auditimeve. Vlera e dëmeve ekonomike dhe e të ardhurave të munguara kap shifra të konsiderueshme për shumë prej bashkive të audituara, duke reflektuar dobësi serioze në qeverisjen vendore. Për më shumë informacion, referojuni *Aneksit 1*.

Tabela 1. Legjislacionit mbi qëndrueshmërinë, energjinë dhe mjedisin në Shqipëri

Kategoria e Shkeljes	Përshkrimi i Shkeljeve	Institucione të Prekura / Shembuj
Shkelje të procedurave të prokurimit publik	Parregullsi në hartimin e dosjeve të tenderit, vlerësim fiktiv i ofertave, shkelje të kriterëve të përzgjedhjes, kontraktme me mungesë gare ose konkurrencë të kufizuar.	Bashkia Elbasan, Fier, Lushnjë, Shkodër, Ura Vajgurore
Menaxhim i dobët financiar / mosarkëtim të ardhurash	Mosarkëtim i të ardhurave nga qiratë, taksat vendore dhe tarifatat; përdorim i fondeve pa dokumentacion justifikues të plotë; planifikim i gabuar buxhetor.	Bashkia Durrës, Divjakë, Kamëz, Pogradec
Shpenzime të pajustificuara ose fiktive	Pagesa për shërbime të pakryera, udhëtime jo-reale, rimbursime jashtë kriterëve, shpenzime operative të fryra ose pa miratim.	Prefektura Fier, Bashkia Lezhë, Sarandë
Shkelje në administrimin e pasurive publike	Dhënie pa kontratë ose me çmime nën vlerë e pasurive publike, mungesë dokumentacioni të regjistrimit dhe përdorim i paligjshëm i pronave të bashkisë.	Bashkia Tiranë, Kavajë, Kukës
Parregullsi në menaxhimin e burimeve njerëzore	Punësime pa konkurse, pagesa për pozicione të pambarim ose në konflikt interesi, mungesë dokumentacioni për dosjet e punonjësve.	Bashkia Berat, Durrës, Kukës
Zbatim joefektiv i rekomandimeve të KLSH	Mungesë progresi në zbatimin e masave të mëparshme, përsëritje e shkeljeve të njëjta ndërvite, dhe mungesë plani veprimi nga institucionet e audituara.	Të gjitha bashkitë dhe prefekturat e audituara

Burimi: Përpunim i të dhënave nga autori, Auditimet e performancës, KLSH³³

NJËSITË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

Auditimi i brendshëm përbën një shtyllë të rëndësishme të sistemit të kontrollit të brendshëm në administratën vendore, i parashikuar nga Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Çdo bashki ka detyrimin ligjor të ketë një njësi të pavarur auditimi të brendshëm, e cila duhet të funksionojë sipas standardeve të miratuara nga Ministria e Financave.³⁴

Pavarësisht se korniza ligjore në Shqipëri garanton një nivel të moderuar të autonomisë autonomisë fiskale të njësive të vetëqeverisjes vendore, zbatimi praktik mbetet sfidues për shkak të mospërputhjes midis kompetencave të deleguara dhe burimeve të financimit. Njësitë e auditimit të brendshëm në shumë bashki funksionojnë në mënyrë të fragmentarizuar dhe me kapacitete të kufizuara, çka ndikon në cilësinë e mbikëqyrjes financiare. Në vitin 2023, 53 nga 61 bashki kishin detyrime të prapambetura, dhe në 11 prej tyre, borxhi i pashlyer ishte më i lartë se të ardhurat totale vjetore. Kjo tregon mangësi të theksuara në disiplinën fiskale dhe në sistemet e kontrollit të brendshëm. Ndonëse ligji përcakton që funksionet e reja duhet të shoqërohen me burime të reja financimi, praktika e vonesave në transfertat ose mungesa e mekanizmave të auditimit të pavarur në nivel vendor pengon zbatimin efektiv të kësaj dispozite. Këto problematika kërkojnë forcimin e kapaciteteve të auditimit

të brendshëm dhe një mekanizëm më të fuqishëm të monitorimit financiar për të garantuar që decentralizimi të shoqërohet me llogaridhënie të qëndrueshme.³⁵

Strukturat e auditimit të brendshëm në njësitë e vetëqeverisjes vendore përfshijnë aktualisht 50 bashki që kanë krijuar njësi të auditimit të brendshëm (NjAB), me gjithsej 134 auditues të punësuar nga 153 të miratuar në strukturat organike. Megjithatë, kapacitetet profesionale të audituesve nuk janë plotësisht në përputhje me kërkesat ligjore: vetëm 74 auditues janë të certifikuar, 30 janë në proces certifikimi dhe 30 të tjerë janë të sapo rekrutuar pa certifikim. Bashkitë më të vogla si Finiqi dhe Libohova e kryejnë auditimin përmes marrëveshjeve me njësi të tjera publike, ndërsa Belshi, Puka, Konispoli, Delvina, Tropoja, Pusteci, Këlcyra, Përmeti dhe Poliçani nuk e realizojnë fare këtë funksion.³⁶ Mungesa e kapaciteteve profesionale dhe mbulimi i paplotë me auditim i bën këto njësi vendore me risk të lartë. Në shumë raste, auditimi kryhet në mënyrë formale, pa rekomandime të dokumentuara dhe pa ndjekje të duhur. Për më tepër, audituesit e brendshëm kanë përgjegjësi për të raportuar menjëherë drejtuesit e njësisë për parregullsitë që mund të përbëjnë vepër penale, por nuk kanë një detyrim ligjor për të raportuar rastet e dyshuara të abuzimit ose korrupsionit drejtpërdrejt autoritetet e ndjekjes penale, gjë që redukton në mënyrë të ndjeshme ndikimin e këtij mekanizmi si instrument parandalues.

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE TË DHËNAT PERSONALE

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe të Dhënat Personale ka mandat të qartë për të monitoruar zbatimin e Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe për të promovuar transparencën në institucionet publike.³⁷ Në kontekstin vendor, ky institucion ka qenë aktiv në vlerësimin e bashkive lidhur me publikimin e Programit të Transparencës³⁸ dhe Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve.³⁹

Raporti vjetor i Komisionerit për vitin 2024 tregon një përmirësim të ndjeshëm në transparencën proaktive të njësive të vetëqeverisjes vendore. Nga 61 njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore (bashki) dhe 12 Këshillat e Qarkut të monitoruar, 30 rezultojnë me transparencë të lartë dhe janë klasifikuar me dritë të gjelbër në indeksin përkatës. Po aq institucione të njësive të vetëqeverisjes vendore (30) janë vlerësuar me transparencë mesatare, ndërsa 13 njësi të vetëqeverisjes vendore janë renditur me transparencë të ulët. Krahasuar me vitin 2023, kur vetëm 29% e bashkive kishin transparencë të lartë, vërehet një rritje e dukshme e performancës. Megjithatë, edhe për këtë vit, janë depozituar 332 ankesa për mosdhënie informacioni ndaj bashkive, që përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të totalit të ankesave, duke treguar se sfidat në zbatimin efektiv të së drejtës për informim vijojnë të jenë të pranishme. Po ashtu, jo të gjitha bashkitë kanë miratuar apo përditësuar programin e transparencës sipas afateve të përcaktuara

ligjërisht, ndërsa në disa raste vijon të mungojë Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, ose ky i fundit është i papërdorshëm për qytetarët.⁴⁰ Problematika të tilla tregojnë për një zbatim formal dhe jo të plotë të legjislacionit, dhe për nevojën e rritjes së kompetencave ndëshkuese të Komisionerit për të siguruar përputhshmëri me standardet ligjore dhe ndërkombëtare.

INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE (ILDKPI)

ILDKPKI është institucioni përgjegjës për kontrollin e pasurive dhe interesave private të zyrtarëve publikë dhe parandalimin e konfliktit të interesit. Në nivel vendor, ai mbikëqyr deklarinë dhe kontrollin e pasurive të kryetarëve të bashkive, këshilltarëve dhe zyrtarëve të tjerë të lartë vendorë.⁴¹ Megjithatë, zbatimi efektiv i legjislacionit për integritetin shpesh has në kufizime, përfshirë mungesën e burimeve dhe mbështetjes teknike në nivel lokal.

Raporti i ILDKPKI për vitin 2023 evidenton një përfshirje të kufizuar të bashkive në mekanizmat e llogaridhënies përmes sistemit të sinjalizimit dhe deklarimit të interesave privatë. Nga 191 Njësitë Përgjegjëse të ngritura në institucionet publike, një pjesë e tyre janë të pranishme edhe në bashki, ku janë trajnuar stafet për zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Gjatë vitit 2023, Bashkia Lushnje raportoi një rast sinjalizimi, i cili nuk përmbushte

kriteret e plotë ligjore dhe për këtë arsye është kërkuar dokumentacion shtesë për hetimin administrativ. Ky është një ndër të paktët rastet e raportuar nga qeverisja vendore, çka tregon nevojën për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve mbikëqyrëse në nivel lokal, rritjen e ndërgjegjësimit institucional dhe garantimin e funksionimit efektiv të njësive përgjegjëse brenda bashkive. Mungesa e sinjalizimeve të tjera dhe shkalla e ulët e referimeve nga ky nivel nënvizojnë boshllëqet në zbatimin e kuadrit ligjor dhe mbikëqyrjen e përdorimit të fondeve publike në njësitë e vetëqeverisjes vendore.⁴²

ROLI I SPAK

PAK (Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar) nuk ka rol të drejtpërdrejtë mbikëqyrës ndaj bashkive në kuptimin administrativ apo institucional, por luan një rol thelbësor në hetimin dhe ndjekjen penale të zyrtarëve vendorë për vepra penale që lidhen me: Korrupsionin në sektorin publik, përfshirë zyrtarët e bashkive; Shpërdorimin e detyrës; Shkeljen e barazisë në tendera dhe prokurime publike; Pasurimin e paligjshëm të zyrtarëve; etj. Referuar nenit 260 të Kodit Penal, për “Korrupsionin pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë”, janë regjistruar 6 raste në vitin 2023 dhe 4 raste në vitin 2024.⁴³ Hetimet e vitit 2023-2025 tregojnë se korrupsioni i zyrtarëve të lartë zhvillohet përmes skemave të sofistikuar, ku faktorë si ndikimi institucional, përfshirja e rrjeteve kriminale dhe pastrimi i parave rrisin nivelin e rrezikut.

Tabela 2. Rastet e Procedimeve Penale të Ndërmarrë nga SPAK ndaj Zyrtarëve të Bashkive (2023–2025)

Nr.	Data	Bashkia	Të Pandehur / Zyrtarë	Akti/Veprimi Ligjor	Akuza Kryesore	Vlera e Dëmit / Përfitimit
1	04.03.2025	Tropojë	Rexhë Byberi dhe Zv/Kryetari Abedin Kërrnaja	Kërkesë për dërgimin për gjykim Ndërtim rruge pa leje dhe pa autorizime institucionale	Shpërdorim detyre në bashkëpunim	277 milionë lekë
2	10.02.2025	Tiranë	Kryetari i Bashkisë Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa	Procedimin penal Përdorim OJF-je për përfitime personale, leje ndërtimi të falsifikuara	Korrupsion, Pastrim parash	110 milionë lekë
3	26.12.2024	Tiranë	8 të pandehur përfshirë Redi Molla, Mariglen Qato	Përfunduar hetimet paraprake për procedimin penal Favorizim në tender për “5D Konstruksion”	Korrupsion, Pastrim parash	193 milionë të përfituara, 334 milionë të sekuestruara
4	07.12.2024	Devoll	Kryetari i bashkisë Eduard Duro, 4 të tjerë	Kërkesë për dërgimin për gjykim Dhënie leje për stacionin e shitjes së karburantit pa dokumentacion ligjor	Shpërdorim detyre	-
5	14.10.2024	Pogradec	Ish-kryetari i Bashkisë Eduart Kapri, B. Meço, B. Niko	Kërkesë për dërgimin për gjykim Leje ndërtimi e paligjshme për një pallat të ndërtuar nga vëllai i kryetarit	Shpërdorim detyre	-
6	22.09.2024	Himarë	Ish Kryetar i Bashkisë Jorgo Goro, 4 të tjerë	Kërkesë për dërgimin për gjykim Legalizim prone me dokumente false, leje ndërtimi fiktive	Shpërdorim detyre, Falsifikim	Pasuri sekuestruara

7	09.09.2024	Tropojë	R. Byberi, A. Kërrnaja	Dërguar për ekzekutim vendimi i Gjykatës Rrugë publike ndërtuar pa leje dhe pa autorizime	Shpërdorim detyre, Dëmtim prone	277.6 milionë lekë
8	23.07.2024	Finiq	Kryetari i bashkisë Leonidha Hristo, 4 të tjerë	Përfunduar hetimet paraprake për procedimin penal Tendera të falsifikuara dhe mungesë dokumentacioni	Shpërdorim detyre	-
9	20.05.2024	Patos	Ish Kryetare e Bashkisë Rajmonda Balilaj, 6 të tjerë	Kërkesë për dërgimin për gjykim Favorizim i operatorëve në tender për mure mbajtëse	Falsifikim, Shkelje barazie në tendera	8.2 milionë lekë
10	25.04.2024	Vorë	Agim Loci	Kërkesë për dërgimin për gjykim Dhënie ryshfeti për ndikim në votim gjatë zgjedhjeve	Korrupsion aktiv në zgjedhje	10,000 lekë
11	08.04.2024	Tropojë	Zenel Çela, Ramiz Bardhi, Rexhep Ismajl isufaj etj.	Përfunduar hetimet paraprake/ Kërkesë me marrëveshje për pranimin e fajësisë Procedura të parregullta në tender për shkollën “Asim Vokshi”	Shkelje në tendera	8.2 milionë lekë
12	05.04.2024	Himarë	Zyrtarë të paimëruar	Vendimi i gjykatës, caktimi i masës së sigurimit pasuror Përvetësim prone nëpërmjet dokumentacioni të falsifikuar	Shpërdorim detyre, Falsifikim	10,592 m ² tokë
13	28.03.2024	Tiranë	Redi Molla, Mari-glen Qato	Filluar hetimet për procedimin penal Procedura të dyshimta tenderimi për favorizim të “5D Konstruksion”	Korrupsion, Shkelje në tendera	-

14	23.03.2024	Himarë	Kryetar i Bashkisë J.G, 4 te tjerë	Vendimi i gjykatës, Caktimin e masës “Arrest në burg”, “Arrest në shtëpi” Përvetësim/ legalizim prone nëpërmjet dokumentacioni të falsifikuar	Shpërdorim detyre, Falsifikim	10,592 m ² tokë
15	09.03.2024	Patos	Ish-Kryetare e Bashkisë Rajmonda Balilaj, 6 të tjerë	Vendimi i gjykatës, Caktimi e masës ndaluese/shtrënguese të sigurimit Favorizim në mënyrë të paligjshme një operator të paracaktuar në dy procedura prokurimi publik.	Falsifikim, Shkelje barazie në tendera	8.2 milionë lekë
16	20.05.2024	Kukës	Zv/kryetari të Bashkisë Kukës	Vendimi i gjykatës, caktimin e masës së sigurimit personal ndalues Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike	Shkelje barazie në tendera	-
17	25.11.2023	Kukës	Ish-Kryetari i Bashkisë Safet Gjici, dhe Alma Kaçin	Kërkesë për dërgimin për gjykim Pranimi i favoreve seksuale në këmbim të mbështetjes për një projekt të propozuar	Korrupsion, Shpërdorim detyre	-
18	16.09.2023	Bulqizë	Ish-Kryetari i Bashkisë Lefter Alla.& 12 të tjerë	Kërkesë për dërgimin për gjykim Skeme të organizuar për favorizimin e një kompanie në tenderin për ndërtimin e ujësjellësit në qytet	Korrupsion, Shkelje barazie në tendera, Shpërdorim detyre, Falsifikim	322 milionë lekë
19	03.07.2023	Dimal	5 zyrtarë te Bashkisë dhe menaxheri i një subjekti privat	Kërkesë për dërgimin për gjykim Skemë e paligjshme lidhur me procedurat urbanistike dhe përfitime të padrejta	Korrupsion, Shpërdorim detyre	-

20	26.07.2023	Tiranë	Erjon Buçuku, zyrtar i bashkisë	Kërkesë për dërgimin për gjykim Marrje ryshfeti për punësime në shkolla publike	Korrupsion pasiv	100,000 – 150,000 lekë
21	07.06.2023	Durrës	Ish-kryetari i Bashkisë Van- gjush Dako dhe 9 zyrtarë	Vendimi i gjykatës, Caktimin e masës së sigurimit Leje ndërtimi në shkelje dhe abuzim me fondet për një promenadë	Shpërdorim detyre, Falsi- fikim	18 milionë lekë
22	16.03.2023	Bulqizë	Ish-Kryetari i Bashkisë Lefter Alla & 12 të tjerë	Vendimi i gjykatës, Caktimin e masës së sigurimit Favorizim i qëllimshëm të një firme të lidhur me kryetarin e bashkisë.	Shkelje e barazisë në tendera, Shpërdorim detyre, Falsi- fikim	322 milionë lekë
23	12.02.2023	Dimal	5 zyrtarë te Bash- kisë dhe 1 sub- jekti privat	Vendimi i gjykatës, Caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” dhe “Arrest në shtëpi”	Korrupsion, Shpërdorim detyre	-

Burimi: Përpunim i të dhënave nga autori, Njoftime për shtyp SPAK⁴⁴

IV. Sfidat Kryesore në Zbatimin e Llogaridhënies Buxhetore

Mekanizmat e llogaridhënies buxhetore në nivel vendor në Shqipëri përballen me një sërë sfidash strukturore, administrative dhe institucionale. Këto sfida jo vetëm që ndikojnë në menaxhimin efektiv të fondeve publike, por krijojnë gjithashtu një mjedis të favorshëm për praktika klienteliste, mungesë konkurrencë në prokurime dhe përfshirje të dobët të qytetarëve.

1.

MUNGESA TË DHËNAVE TË SISTEMATIZUARA DHE ANALIZËS SË RREZIKUT

Një nga sfidat më të mëdha qëndron në mungesën e të dhënave të sistematizuara dhe analizës së rrezikut lidhur me menaxhimin buxhetor vendor. Raportet për pjesëmarrjen qytetare në buxhetimin vendor theksojnë nevojën për “matje dhe raportim të vazhdueshëm mbi përmbushjen e objektivave strategjike”, për të reduktuar hapësirën për manipulime të qëllimshme të të dhënave dhe për të ndërtuar një kulturë institucionale kundër korrupsionit⁴⁵. Në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për mbledhjen, përpunimin dhe analizën e të dhënave mbi ekspozimin ndaj korrupsionit,

efektivitetin e instrumenteve të integritetit apo rastet konkrete të shkeljeve dhe masave disiplinore, mbikëqyrja dhe transparenca bëhen të pamundura për institucionet përgjegjëse dhe shoqërinë civile.

Bashkitë shqiptare përballen me një gamë të gjerë problematikash financiare dhe administrative, të cilat shpesh nuk përpunohen sistematikisht për të ndërtuar një analizë të qëndrueshme të riskut apo për të orientuar masat parandaluese dhe ndëshkuese. Auditimet e KLSH-së (shih *Aneksin 1*) tregojnë se mospërputhja e llogarive, mungesa e inventarizimit, mosrakordimi i të dhënave financiare, mungesa e sistemeve të menaxhimit të riskut dhe të amortizimit janë probleme të përhapura në shumicën e bashkive, duke e bërë të pamundur ndërtimin e një panorame të qartë të gjendjes së financave publike.

Këto mangësi nuk janë vetëm teknike, por kanë pasoja të drejtpërdrejta në qeverisjen vendore, duke përfshirë: pamundësinë për të matur progresin real në menaxhimin buxhetor; mungesën e treguesve të rrezikut dhe të alarmit të hershëm; dobësi në kontrollin dhe mbikëqyrjen nga brenda dhe jashtë institucionit; dhe vonesë në marrjen e masave për shkelje të përsëritura ose abuzime financiare.

Tabela 3. Grupimi i Bashkive sipas Problemave në të Dhëna dhe Transparencë Buxhetore

Problematika	Karakteristikat Kryesore	Shembuj Bashkish
Mungesë e theksuar të dhënash, kontabilitet të pasaktë dhe risk i lartë	Mungesë inventarizimi, pasqyrime jo reale në llogaritë financiare, borxhe të pambledhura të mëdha, mungesë kontrolli të brendshëm.	Kamëz, Vau i Dejës, Lezhë, Kavajë, Divjakë
Mungesë përpunimi analitik dhe klasifikimi të dobët të aktiveve dhe detyrimeve	Mbivlerësim/nënvlerësim i pasqyrave kontabël, mungesë ndarjeje sipas aktiveve, pasaktësi në regjistrat financiarë.	Pustec, Devoll, Pogradec, Roskovec, Cërrik
Të ardhura të mëdha të pambledhura dhe mungesë ndjekjeje për debitorët	Të ardhura të munguara nga taksa e ndikimit, qiratë, tarifat lokale; mungesë masash ndëshkuese.	Sarandë, Tropojë, Selenicë, Libohovë, Belsh
Probleme në analizën e riskut dhe mungesë auditimi të brendshëm efektiv	Mosfunksionim i mekanizmave të MFK, mungesë komiteti auditimi, mungesë strategjie për menaxhimin e riskut.	Gjirokastër, Përmet, Has, Mat, Dropull

Burimi: Përpunim i të dhënave nga autori, Auditimet e performancës, KLSH⁴⁶

AUDITIMI I BRENDSHËM JOEFEKTIV DHE MUNGESA E DOKUMENTIMIT TË AUDITIMEVE

Auditimi i brendshëm në NJQV rezulton të jetë shpesh formal, me ndikim të kufizuar në përmirësimin e proceseve. Sipas të dhënave të KLSH-së, shumë NJQV nuk kanë auditues të kualifikuar dhe të pavarur.

Auditimet kryhen pa dokumentacion të plotë ose nuk përmbajnë analiza të thelluara të performancës buxhetore. Rekomandimet shpesh nuk merren parasysh ose nuk ndiqen në praktikë. Këto të meta minojnë vetë funksionin mbikëqyrës të auditimit të brendshëm dhe krijojnë hapësira për shkelje sistematike pa ndëshkueshmëri.⁴⁷

Tabela 4. Ilustrim i Problematikave kryesore të konstatuara në Auditimin e Brendshëm

Bashkia Përmet	Mungesë e gjurmës së auditimit në shumë procese; mungesë strukturash dhe kapacitetesh për auditim
Bashkia Libohovë	Mungesë e gjurmës së auditimit dhe kontrolleve të brendshme; mungesë strukturash të trajnimit
Bashkia Gramsh	Mungesë zbatim i sistemit të kontrollit të brendshëm; zbatim i dobët i rekomandimeve të mëparshme
Bashkia Finiq	Mosfunksionim i mekanizmave të MFK, mungesë komiteti auditimi, mungesë strategjie për menaxhimin e riskut.
Bashkia Gjirokastrë	Mungesë sistemi të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm; zbatim i vonuar i rekomandimeve
Bashkia Has	Njësia e Auditimit të Brendshëm jo funksionale; planifikim auditimi vetëm 50%; mungesë strategjie risku dhe përshkrimesh pune
Bashkia Dropull	Strukturë jo e plotësuar në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, Mungesë kuadri të plotë të kontrollit të brendshëm sipas MFK (Kontrolli dhe Menaxhimi Financiar)

Burimi: Përpunim i të dhënave nga autori, Auditimet e performancës, KLSH⁴⁸

PROKURIMET PUBLIKE, MUNGESA E KONKURRENCËS DHE EKSPLOZIMI NDAJ KLIENTELIZMIT

Prokurimet publike në nivel vendor paraqesin një nga fushat me rrezikun më të lartë për korrupsion dhe keqpërdorim të fondeve publike. Analizat e fundit të Agjencisë së Prokurimit Publik tregojnë se vetëm 34% e procedurave të asistuara nga institucionet vendore janë pa problematika, ndërkohë që 66% kanë rezultuar me konstatime, duke evidentuar mangësi të konsiderueshme në zbatimin e rregullave.⁴⁹ Një pjesë e madhe e këtyre mangësive lidhet me kriteret e paqarta dhe diskriminuese për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, përdorimin e procedurave me negociim të drejtpërdrejtë, si dhe me përzgjedhjen e dyshimtë të fituesve pa argumentim teknik të qartë. Gjithashtu, zvarritja në zbatimin e kontratave dhe mosrespektimi i specifikimeve teknike theksojnë nevojën për një kontroll më të rreptë dhe menaxhim më të përgjegjshëm të prokurimeve. Auditimet e KLSH për periudhën 2024-2025 tregojnë se një numër i konsiderueshëm i bashkive kanë zhvilluar procedura prokurimi në kundërshtim me ligjin.

Tabela 5. Përmbledhje e bashkive me problematika të theksuara në fushën e prokurimeve publike

Grupi i Bashkive	Bashkitë	Problematikat kryesore	Efekti financiar negativ (lekë)
Shkelje të rënda dhe dëm i lartë ekonomik	Cërrik, Malësi e Madhe, Roskovec	Prokurime me shkelje ligjore sistematike, punime të pakryera, OE të pakualifikuar	Cërrik: 770 mln & 70 mln Malësi e Madhe: 344 mln Roskovec: 124 mln
Mospërputhje ligjore, kualifikime të dyshimta	Vau i Dejës, Sarandë, Kolonjë, Shijak, Kavajë	Skualifikime të padrejta, kontrata mbi ofertat, dokumentacion i paplotë, punime të pakryera	Vau i Dejës: 20 mln+ Sarandë: 22 mln+17 mln+9 mln Kolonjë: 24 mln
Procedura të paqarta apo të shman-gura pjesërisht	Gramsh, Përmet, Kamëz, Libohovë, Fushë Arrëz	Projekte pa procedura, mungesë transparence, dobësi në dokumentacion, përfshirje e strukturave të përkohshme	Gramsh: 985 mijë Përmet: 1 mln KLSH s’jep shifra për Kamëz/ Libohovë
Prefekturat me rrezik klientelizmi në prokurime	Tiranë, Fier, Korçë, Shkodër, Vlorë	Procedura të copëzuara, mungesë dokumentacioni ligjor, konflikt interesi në komisione	Jo e detajuar në vlerë monetare, por e përsëritur në të gjitha prefekturat

Burimi: Përpunim i të dhënave nga autori, Auditimet e performancës, KLSH⁵⁰

Këto të dhëna nënvizojnë nevojën për ndërhyrje urgjente në forcimin e strukturave të kontrollit të brendshëm, ngritjen e kapaciteteve, trajnime e certifikim profesional për stafin vendor të angazhuar në prokurime, dhe rritjen e transparencës në të gjitha fazat e procesit të prokurimit publik.

4.

SHKELJET NË REKRUTIME, DHE DOBËSITË NË ZBATIMIN E LIGJIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Një nga fushat më të prekura nga praktikat klienteliste në njësitë e qeverisjes vendore mbetet rekrutimi i stafit. Sipas raportit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC) për vitin 2024, vlerësimi i strukturës organizative dhe i skemës së administrimit të shërbimit civil evidentoi se rreth 9% e bashkive nuk kanë ngritur mekanizmat e nevojshëm për zbatimin e Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”,⁵¹ siç janë komitetet për vlerësimin e pozicioneve të punës dhe dokumentacioni përkatës mbështetës për përshkrimin dhe klasifikimin e tyre.⁵² Në shumë bashki, proceset e rekrutimit nuk zhvillohen në përputhje me procedurat ligjore, pasi mungojnë planet e rekrutimit dhe përshkrimet e punës të miratuara në mënyrë transparente. Kjo situatë tregon për një dobësi serioze në zbatimin praktik të standardeve të shërbimit civil dhe për një nivel të ulët profesionalizmi në administratën vendore. Për më tepër, raporti thekson se pozicionet e punës shpesh nuk janë klasifikuar në mënyrë të saktë në raport me funksionet që përmbushin, gjë që shkakton paqartësi në ndarjen midis vendeve që i përkasin shërbimit civil dhe atyre që nuk i nënshtrohen këtij statusi. Raporti i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC) për vitin 2023⁵³, pasqyron se:

- 945 pozicione në administratat vendore janë zënë në mënyrë të paligjshme përmes emërimeve të përkohshme;
- Shumëngapozicionet jashtë skemës së shërbimit civil nuk i nënshtrohen asnjë konkursi apo vlerësimi;
- Nuk ka transparencë në përzgjedhjen dhe vlerësimin e kandidatëve.

Këto problematika rëndohen më tej nga faktorë të tjerë strukturorë. Shqipëria është ndër vendet më të prekura nga emigracioni masiv: rreth 40% e fuqisë punëtore shqiptare vlerësohet se punon jashtë vendit, duke gjeneruar një “ikje truri dhe krah pune” që ushtron presion të drejtpërdrejtë mbi tregun vendas dhe mbi administratën, e cila humbet vazhdimisht punonjës si në sektorët me kualifikim të ulët, ashtu edhe në ata me kualifikim të lartë.⁵⁴

4.

MEKANIZMAT E SINJALIZIMIT TË KORRUPSIONIT: MUNGESA OSE MOSFUNKSIONIMI

Ligji nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”⁵⁵ përfaqëson një përpjekje të rëndësishme për të ngritur një sistem funksional që promovon integritetin institucional dhe fuqizon qytetarët apo punonjësit të denoncojnë praktikën korruptive, pa frikë nga pasojat. Ky ligj përcakton detyrime të qarta për institucionet publike dhe subjektet private në lidhje me

ngritjen e mekanizmave të brendshëm të sinjalizimit, administrimin e rasteve të raportuara dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga çdo formë represioni. Megjithatë, zbatimi i ligjit në praktikë, sidomos në nivelin vendor, ka qenë tejet i kufizuar dhe problematik. Raporte ndërkombëtare kanë vlerësuar se ligji ka mangësi serioze në mbrojtjen efektive të sinjalizuesve, gjë që konsiderohet një nga arsyet kryesore të mosfunksionimit të tij. Ligji duhet të ndryshohet për të përcaktuar qartë se çfarë përbën sinjalizim të mbrojtur, për të krijuar kanale raportimi të sigurta dhe konfidenciale dhe për të ndaluar në mënyrë të qartë çdo formë represioni.⁵⁶

Gjetjet e monitorimeve të pavarura të realizuara nga organizatat e shoqërisë civile si Komiteti Shqiptar i Helsinkit, tregojnë se shumica dërrmuese e bashkive në vend nuk kanë ngritur njësi të posaçme apo struktura të dedikuara për administrimin e sinjalizimeve, siç kërkohet nga ligji. Në një raport monitorimi të vitit 2023, ku u analizua situata në nëntë bashki të vendit, konstatohet se në asnjërën prej tyre nuk është regjistruar ndonjë sinjalizim i brendshëm dhe se mungojnë struktura të mirëfillta apo të trajnuara për trajtimin e këtyre çështjeve. Mungesa e besimit, frika nga hakmarrja, mungesa e trajnimeve dhe burimeve, si dhe mosfunksionimi i duhur i kanaleve të komunikimit kanë penguar sinjalizimin efektiv. Në shumë raste, anëtarët e njësive ushtrojnë këtë funksion përveç detyrave të tjera, pa mbështetje adekuate apo vlerësim institucional. Edhe në ato raste ku është emëruar një person përgjegjës për sinjalizimin, mungojnë burimet njerëzore

dhe financiare për realizimin efektiv të këtij funksioni.⁵⁷ Ndërkohë, monitorimi i vitit 2020 nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit tregoi se në dhjetë bashki të mëdha vetëm një rast sinjalizimi i brendshëm ishte regjistruar, konkretisht në Bashkinë e Tiranës, ku megjithëse procedurat administrative u ndoqën formalisht, sinjalizimi u mbyll pa gjetur elementë të korrupsionit.⁵⁸

Për më tepër, shumë njësi të qeverisjes vendore nuk kanë miratuar ende rregullore të brendshme për trajtimin e sinjalizimeve dhe zhvillimin e hetimeve administrative që burojnë prej tyre. Kjo mungesë e dokumentacionit të brendshëm rregullator krijon një boshllëk të rëndësishëm në procedura dhe bie ndesh me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore përkatëse. Një tjetër faktor dekurajues është mungesa e besimit të qytetarëve dhe punonjësve në institucionet përgjegjëse për administrimin e sinjalizimeve. Në komunitete të vogla, ku marrëdhëniet sociale janë më të ngushta dhe mundësitë për anonimitet janë të kufizuara, frika nga përjashtimi, hakmarrja apo humbja e vendit të punës është reale. Raportime të Koalicionit të Evropës Juglindore për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dëshmojnë se niveli i besimit publik të mekanizmat mbrojtës ndaj sinjalizuesve mbetet i ulët.⁵⁹ Për më tepër, kufizimet në vetë ligjin, i cili nuk ofron mbrojtje për sinjalizimet publike (pra ato të bëra përmes medias apo rrjeteve sociale), përforcojnë perceptimin se individët janë të pambrojtur nëse vendosin të raportojnë raste korrupsioni.

PROGRAMET E TRANSPARENCËS DHE KUFIZIMI REAL I AKSESIT TË QYTETARËVE

Sipas raportit të Anketimit të Buxhetit të Hapur 2023, Shqipëria ka një rezultat të përgjithshëm transparence prej 57 pikësh nga 100, nën pragun minimal për të mundësuar debat publik të informuar mbi buxhetin, ndërsa mbikëqyrja buxhetore vlerësohet si “e mjaftueshme” me 67 pikë, falë rolit të fortë të Kontrollit të Lartë të Shtetit (72 pikë) dhe mbikëqyrjes parlamentare në fazën e planifikimit (64 pikë). Megjithatë, pjesëmarrja publike në procesin buxhetor mbetet shumë e ulët, me vetëm 9 pikë, dhe mungesa e dokumenteve si Buxheti për Qytetarët përkeqëson aksesin e publikut në informacion të kuptueshëm. Këto tregues theksojnë nevojën për forcimin e rolit të institucioneve mbikëqyrëse dhe krijimin e mekanizmave efektivë për angazhimin e qytetarëve në të gjitha fazat e ciklit buxhetor.

Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” detyron njësitë e qeverisjes vendore të publikojnë informacion në mënyrë proaktive dhe në praktikë vetëm një numër i konsiderueshëm bashkish kanë miratuar dhe zbatojnë programe transparence të harmonizuara me modelin e rekomanduar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Megjithëse përfshirja e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në monitorimin e qeverisjes vendore është një komponent thelbësor për sigurimin e

llogaridhënies, transparencës dhe integritetit institucional, në realitetin shqiptar, kjo përfshirje mbetet sporadike, me ndikim të kufizuar dhe shpeshherë më shumë formale sesa substanciale, për shkak të mungesës së mekanizmave të institucionalizuar, burimeve të qëndrueshme financiare dhe një kulture të konsoliduar të pjesëmarrjes qytetare. Një praktikë e mirë e nisur rishtazi në nivel kombëtar është edhe publikimi i dokumentit “Buxheti për Qytetarët” nga Ministria e Financave, i cili synon të bëjë buxhetin më të kuptueshëm për qytetarët dhe të rrisë përfshirjen në vendimmarrje përmes paraqitjes vizuale dhe të thjeshtuar të të dhënave financiare, qasje e cila duhet të zgjerohet edhe në nivel vendor.

Organizatave të shoqërisë civile, veçanërisht ato që veprojnë në nivel vendor, kanë një potencial të rëndësishëm për edukimin qytetar, monitorimin e prokurimeve publike, promovimin e transparencës në vendimmarrje, si dhe për adresimin e rasteve të abuzimit me fondet publike. Përmes projekteve të mbështetura nga partnerë ndërkombëtarë si Bashkimi Evropian, GIZ, UNDP dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, një sërë OSHC-sh kanë krijuar instrumente të vlefshme për rritjen e llogaridhënies buxhetore. Një prej iniciativave më të konsoliduara është platforma Open Spending Albania, e zhvilluar nga Instituti Shqiptar i Shkencës (AIS), e cila ofron të dhëna të hapura mbi kontratat publike, shpenzimet dhe klientelizmin në prokurimet vendore. Po ashtu, Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim (GADC) në raportin e saj “Analiza Ligjore

e Procesteve të Konsultimit Publik 2024”, evidenton se konsultimet publike në nivel vendor shpesh mbeten formale dhe jo gjithëpërfshirëse, me mospërmbushje të detyrimeve ligjore sidomos për çështje buxhetore.

Megjithëse këto nisma tregojnë përparim të rëndësishëm, ato shpesh janë të përkohshme dhe të varura nga mbështetja e jashtme financiare. Si rezultat, qytetarët përballen me pengesat e shumta për të siguruar informacion të besueshëm dhe të përdorshëm për mënyrën se si përdoren fondet publike në nivel lokal. Këto kufizime nuk janë thjesht teknike, por përbëjnë një sfidë serioze për llogaridhënien demokratike dhe efektivitetin e mbikëqyrjes së institucioneve publike. Prandaj, forcimi i mekanizmave të pjesëmarrjes, standardizimi i programeve të transparencës dhe zbatimi i monitoruar i legjislacionit ekzistues janë hapa të domosdoshëm për të ndërtuar besim të ndërsjellë mes qytetarëve, OSHC-ve dhe institucioneve dhe për të marrë pjesë në mënyrë të informuar dhe efektive në proceset e mbikëqyrjes buxhetore.

Në këtë drejtim, përvoja ndërkombëtare ofron modele të vlefshme, si auditimi social, ku komunitetet dhe përfituesit e projekteve përfshihen drejtpërdrejt në monitorimin e investimeve vendore, duke garantuar cilësinë e projekteve dhe duke kufizuar hapësirat për praktika korruptive. Zbatimi i ngjashëm i këtyre praktikave në Shqipëri do të mund të rriste ndjeshëm nivelin e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies në qeverisjen vendore.

6.

PROGRAMET E TRANSPARENCËS DHE KUFIZIMI REAL I AKSESIT TË QYTETARËVE

Sipas raportit të Anketimit të Buxhetit të Hapur 2023, Shqipëria ka një rezultat të përgjithshëm transparence prej 57 pikësh nga 100, nën pragun minimal për të mundësuar debat publik të informuar mbi buxhetin, ndërsa mbikëqyrja buxhetore vlerësohet si “e mjaftueshme” me 67 pikë, falë rolit të fortë të Kontrollit të Lartë të Shtetit (72 pikë) dhe mbikëqyrjes parlamentare në fazën e planifikimit (64 pikë). Megjithatë, pjesëmarrja publike në procesin buxhetor mbetet shumë e ulët, me vetëm 9 pikë, dhe mungesa e dokumenteve si Buxheti për Qytetarët përkeqëson aksesin e publikut në informacion të kuptueshëm. Këto tregues theksojnë nevojën për forcimin e rolit të institucioneve mbikëqyrëse dhe krijimin e mekanizmave efektivë për angazhimin e qytetarëve në të gjitha fazat e ciklit buxhetor.

Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” detyron njësitë e qeverisjes vendore të publikojnë informacion në mënyrë proaktive dhe në praktikë vetëm një numër i konsiderueshëm bashkish kanë miratuar dhe zbatojnë programe transparence të harmonizuara me modelin e rekomanduar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Megjithëse përfshirja e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në monitorimin e qeverisjes vendore është një komponent thelbësor për sigurimin e

V. Rekomandime për Përmirësimin e Llogaridhënies dhe Integritetit në Nivel Vendor

KUADRI STRATEGJIK DHE LIGJOR

- Krijimi i një funksioni të dedikuar për pajtueshmërinë kundër korrupsionit brenda çdo NJQV-je, me përgjegjësi të qarta për koordinimin e masave parandaluese dhe monitorimin e rasteve të konfliktit të interesit, sinjalizimeve dhe shkeljeve disiplinore.
- Ngritja e një sistemi kombëtar të monitorimit të angazhimeve për transparencë dhe anti-korrupsion të NJQV-ve, i cili të përfshijë raportim vjetor mbi tregues sasiorë dhe cilësorë, mekanizma “peer-review” me përfshirjen e shoqërisë civile.

Detyrimi ligjor që NJQV-të të regjistrojnë dhe publikojnë të gjitha incidentet e integritetit (korrupsion, konflikt interesi, shkelje disiplinore), të analizojnë shkaqet dhe të përshkruajnë masat parandaluese që janë marrë.
- Detyrimi ligjor që audituesit të raportojnë drejtpërdrejt te autoritetet ligjzbatuese çdo tregues të korrupsionit ose mashtrimit të konstatuar, duke parashikuar sanksione për moszbatim.

AUDITIMI DHE KONTROLLI

- Pajisja e Njësive të Auditimit të Brendshëm me staf të trajnuar dhe të certifikuar, status të garantuar të pavarësisë funksionale dhe buxhet të dedikuar. Këto njësi duhet të realizojnë auditime periodike të masave kundër korrupsionit, duke përfshirë edhe entitetet e varësisë.

Krijimi i një regjistri elektronik publik për të ndjekur në kohë reale zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe atij të KLSH-së. Ky regjistër duhet të jetë i aksesueshëm për qytetarët dhe institucionet mbikëqyrëse.
- Diskutimi i raportit vjetor të njësisë së auditit të bëhet detyrim ligjor dhe të përfshihet në rendin e ditës së Këshillit Bashkiak, duke i mundësuar Këshillit të ushtrojë kontroll efektiv mbi punën e ekzekutivit.
- Krijimi i zyrave të auditimit në nivel qarku, veçanërisht për bashkitë e vogla, për të kompensuar mungesën e ekspertizës në nivel lokal. Raportet e auditimit të trajtohen në Këshillat Bashkiakë, sipas praktikave të disa

bashkive që përdorin auditues nga bashkitë e tjera.

- Fuqizimi i rolit të këshillave bashkiake në kërkimin e auditimeve të jashtme. Aktualisht, ligji u jep këshillave këtë të drejtë, por praktika nuk është zbatuar. Ligji duhet të ndryshohet për ta bërë kërkesën të detyrueshme kur ajo vjen nga një numër i caktuar anëtarësh të Këshillit.
- Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore dhe digjitale të KLSH-së për të siguruar auditim vjetor të çdo bashkie dhe ndjekje të rregullt të zbatimit të rekomandimeve.

PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I INTEGRITETIT

- Hartimi dhe zbatimi i detyrueshëm i planeve të integritetit, të mbështetur në një metodologji kombëtare të konsoliduar për vlerësimin e riskut të korrupsionit në nivel vendor, e cila të fokusohet në shërbimet publike me risk të lartë dhe pozicionet e ekspozuara në administratë.
- Raportimi mbi zbatimin e planeve të integritetit duhet të përfshijë elementë cilësorë, jo vetëm sasiorë, dhe të shoqërohet me misione peer-review ku marrin pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, biznesit dhe administratës.

TRANSPARENCA DHE PJESËMARRJA

- Krijimi i një platforme të unifikuar kombëtare për publikimin e të gjitha të dhënave vendore (ngjashëm me platformën “Transparent Albania”) mbi financat publike, kontratat, tenderët dhe rezultatet e auditimeve.
- Detyrimi për publikimin e “Buxhetit për Qytetarët” nga çdo NJQV, në një format të thjeshtë, vizual dhe lehtësisht të kuptueshëm për publikun e gjerë.
- Krijimi i Këshillave të Integritetit Vendor, me përfaqësim të balancuar nga administrata, organizatat e shoqërisë civile dhe komuniteti, për të mbikëqyrur përdorimin e burimeve publike dhe zbatimin e planeve të integritetit.
- Zbatimi i buxhetimit pjesëmarrës, duke dedikuar një përqindje fikse të buxhetit vendor për projekte të votuara nga qytetarët dhe duke krijuar fonde të vogla për nisma komunitare që synojnë transparencën dhe mbikëqyrjen sociale.

PROKURIMI PUBLIK DHE MENAXHIMI FINANCIAR

- Pilotimi i marrëveshjeve të integritetit (“integrity pacts”) për kontratat e mëdha publike në nivel vendor, si mekanizëm për të siguruar mbikëqyrje të pavarur dhe transparencë gjatë procesit të prokurimit.
- Krijimi i një regjistri të riskut të korrupsionit për çdo fazë të procesit të prokurimit publik, i shoqëruar me trajnime të detyrueshme për stafin përgjegjës.
- Publikimi i plotë dhe në format të hapur i të gjitha kontratave të nënshkruara nga NJQV-të dhe entitetet e varësisë, përfshirë çdo ndryshim apo aneks kontrate.

SINJALIZIMI DHE MBROJTJA E SINJALIZUESVE

- Përshtatja e kuadrit ligjor me Direktivën (BE) 2019/1937, përfshirë lejimin e raportimit anonim, ofrimin e ndihmësligjore falas për sinjalizuesit dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës me procedurë të përshpejtuar për ndalimin e menjëhershëm të hakmarrjes.
Vendosja e sanksioneve të rënda për çdo person që shkel konfidencialitetin mbi identitetin e sinjalizuesit.
- Krijimi i platformave digjitale të sigurta për sinjalizim, që lejojnë akses të kufizuar, gjurmueshmëri të veprimeve dhe raportim mbi masat e marra.

REKRUTIMI DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

- Detyrimi që të gjitha vendet vakante, përfshirë ato të përkohshme, të publikohen në një platformë kombëtare të rekrutimit, me afat minimal aplikimi për të garantuar konkurrencë të barabartë.
- Hartimi i një ligji të posaçëm mbi punësimin në sektorin publik, bazuar në Kodin e Punës, për të kufizuar emërimet e përkohshme pa konkurs dhe për të siguruar transparencë e llogaridhënie në përzgjedhje.

Aneksi 1. Të Dhëna Përmbledhëse mbi Auditimet e Performancës së Bashkive nga KLSH (2024–2025)

	Insti- tucioni i Audituar	Viti	Demi/Efekti Financiar (lekë) (i detajuar)	Fusha Kryesore e Problematikave (të detajuara)	Nr. Gjet- jeve	Nr. Re- koman- dimeve
1	Bashkia Sarandë	2025	- 62,061,075 lekë – të ardhura të munguara nga taksat dhe tarifat vendore - 22,142,400 lekë – efekt negativ financiar nga shmangia e procedurave të prokurimit - 17,315,695 lekë – shpenzime për aktivitete kulturore pa ndjekur procedura prokurimi - 9,928,993.36 lekë – punime të pa kryera në zbatim kontratash	- Mospasqyrim i saktë i aktiveve (pyje, kullota, ndërtesa) në pasqyrat financiare - Mungesë procedurash për inventarizim dhe certifikim pronësie - Mangësi në administrimin e të ardhurave vendore - Probleme serioze në procedurat e prokurimit publik, shpallje fituesish me dokumentacion jo të rregullt - Mospërputhje me kriteret ligjore për lejet e ndërtimit dhe certifikatat e përdorimit	56	67
2	Bashkia Lezhë	2025	- 33,615,932 lekë mbivlerësim i llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për 8 fatura të regjistruara gabimisht; - 146,400 lekë humbje nga përlllogaritje e gabuar në kontratë qiraje; - 278,035,252 lekë detyrime të pambledhura nga taksat dhe tarifat vendore; - 25,108,199 lekë mbivlerësim në llogarinë 467 nga 17 fatura për mallra; - 825,112 lekë mbivlerësim në llogarinë “Teprica”	-Regjistrime kontabël të pasakta dhe mbivlerësime në disa llogari financiare; - Moszbatim i përlllogaritjeve të saktë për kontratat e qirasë; - Mungesë e inventarizimit periodik dhe mosregjistrim i plotë i aseteve të transferuara; - Raportim i gabuar në përlllogaritjen e treguesit të vështirësisë financiare; - Detyrime të larta të pambledhura nga taksat dhe tarifat vendore.	15	16
3	Bashkia Vau i Dejës	2025	- 4,443,250 lekë – punime të pakryera në kontrata ndërtimi - 2,752,040.7 lekë – lidhje kontrate mbi ofertën fituese në kundërshtim me ligjin - 13,052,857 lekë – skualifikim i padrejtë i OE-ve në procedura prokurimi - 1,528,196 lekë – përfitim i padrejtë TVSH nga operatorë - 287,305,828 lekë – debitorë të paregjistruar të taksave vendore	- Mangësi serioze në procedurat e prokurimit publik dhe zbatim kontratash - Inventarizim i paplotë dhe mungesë e regjistrimit të pronave - Mospasqyrim i saktë i pasqyrave financiare dhe mungesë e evidencës për amortizim dhe investime - Shkelje të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm	776	85

			guara nga mosrealizimi i planit - 12,950,529 lekë – të ardhura të munguara për shkak të mospërmbarimit - 70,236,317 lekë – detyrime të prapambetura pa likuiduar - 438,072,449 lekë – mosreflektim i investimeve në njësitë varëse - 96,800,310 lekë – mungesë kundërpattie për grantet kapitale	- Probleme të theksuara në realizimin dhe arkëtimin e të ardhurave vendore - Mungesë masash ligjore ndaj debitorëve me detyrime të mbartura - Moszbatim i procedurave të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar - Lidhje kontratash me vlerë më të lartë se oferta, dhe mosarkëtim i garancive të ofertës		
4	Bashkia Vorë	2025	- 73,463,454 lekë (moskontabilizim i detyrimeve tatimore dhe stokut të prapambetur) - 11,506,064 lekë (fatura të kontabilizuara pa ofrim shërbimi) - 7,921,949 lekë (qira të papaguara nga subjekti “A D” sh.p.k) - Realizim i ulët i të ardhurave nga taksat vendore: 408,964,000 lekë nga 565,300,000 lekë (<72% realizim>) - Shpenzime të parealizuara: 1,275,699,000 lekë nga 1,748,708,000 lekë (<73% realizim>) - Stok detyrimesh të prapambetura: 376,288,910 lekë	- Realizim i pamjaftueshëm i të ardhurave dhe shpenzimeve krahasuar me planifikimin - Mungesë kontabilizimi dhe raportimi i detyrimeve dhe debitorëve - Shkelje në menaxhimin e pasurive të paluajjtshme - Detyrime të kontabilizuara gabimisht (furnitorë pa kontrata) - Qira të papaguara për pronë të dhëna me kontratë afatgjatë - Mungesë të dhënash për disa kreditorë - Rrezik nga procese gjyqësore për vonesa në pagesa dhe mungesë të dorëzimit të mallrave/shërbimeve sipas kontratave	27	32
5	Bashkia Kamëz	2025	- 409,245,000 lekë të ardhura të parealizuara nga taksat dhe tarifat vendore - 373,927,000 lekë detyrime të prapambetura (137.9 mln lekë nga të ardhurat e veta, 236 mln lekë nga buxheti i shtetit) - 1,003,472,962 lekë kontabilizime pa certifikatë pronësie në llogarinë 212 - 2,841,437,423 lekë kontabilizime pa certifikatë pronësie në llogarinë 213 - 126,985,233 lekë borxhe tatimore nga abonentë privatë	- Mungesë trajnimesh, planeve të veprimit dhe raportimi të brendshëm për etikën dhe kontrollin - Mosrealizim i të ardhurave sipas planit për taksat dhe tarifat vendore - Detyrime të mëdha të prapambetura për shërbime, mallra dhe investime - Kontabilizim i pasaktë i aktiveve pa vlerë ose pa certifikatë pronësie - Probleme në administrimin e pasurive publike dhe proceset e legalizimit - Borxhe të pambledhura tatimore ndaj bizneseve dhe individëve - Aktivitet ekonomik pa autorizime në tregtimin e hidrokarbureve	19	20
6	Bashkia Kavajë	2025	- 182,845,257 lekë – nënvlerësim i llogarisë “Disponibilitete në thesar” - 18,912,086 lekë – moskuadrim në llogarinë e inventarit të imët - 1,536,878,023 lekë – mbivlerësim i llogarisë 101 “Teprica”r	- Mospërputhje të llogarive financiare me dokumentacionin mbështetës - Probleme me kontabilizimin dhe mbivlerësimin e fondeve të akumuluar	25	33

			- 43,351,345 lekë – diferencë në investimet në proces - 599,090,510 lekë – mbivlerësim në llogarinë “Pjesëmarrje në kapital” - 100,000 lekë – moskontabilizim i kreditorëve të ndryshëm - 715,446 lekë – diferencë në llogarinë 411 “Klientë” - 29,552,098 lekë – diferencë në llogarinë 215 “Mjete transporti” - 1,775,081 lekë – nënvlerësim i investimeve për aktive jo materiale - Vlera të paanalizuara për rreth 1.5 miliardë lekë në llogaritë e aktiveve dhe investimeve	- Investime të paklasifikuara saktë sipas natyrës së tyre (aktive materiale/ jo materiale) - Llogari të ndryshme financiare me pasqyrim të pasaktë ose të paanalizuar - Llogari kreditorësh me mungesa në analizat shoqëruese - Mungesë kontabilizimi për të ardhurat në pritje - Parregullsi në kontabilizimin e debitorëve, kryesisht nga taksa e ndikimit në infrastrukturë - Shkelje të praktikave standarde kontabël për amortizimin dhe njohjen e aktiveve		
7	Bashkia Tropojë	2025	- 33,117,410 lekë – detyrime të pashfaqura ndaj shtetit - 28,770,766 lekë – të ardhura të paarkëtuara nga 268 biznese dhe 4 institucione - 2,600,000 lekë – të ardhura të paarkëtuara nga subjekte të hidrokarbureve - 773,644 lekë – të ardhura të paarkëtuara nga taksa infrastrukturë - 973,000 lekë – të ardhura të paarkëtuara nga tarifa e kantierit - 1,600,000 lekë – të ardhura të munguara nga gjobat e IMTV - 360,320 lekë – të ardhura të munguara nga taksa e fjetjes - 11,021,770 lekë – të ardhura të munguara nga qiratë - 33,090,778 lekë – detyrime të prapambetura nga vendime gjyqësore - 48,703,000 lekë – fatura të papaguara në fund të vitit - 6,748,542 lekë – pasqyrim më pak në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” - 3,452,393 lekë – diferencë në llogarinë 215 “Mjete transporti” - 22,449,624 lekë – garanci kontratash të skaduara të pakthyera	- Mosarkëtim dhe moskontabilizim i të ardhurave vendore - Probleme në planifikimin real të buxhetit dhe në zbatimin e tij - Detyrime të pashfaqura në mënyrë korrekte ndaj MF - Mospërputhje të vlerave në pasqyrat financiare dhe mungesë e inventarizimit të pasurive - Garanci të kontratave të pakthyera, të skaduara - Mospërputhje në kontabilizimin e mjeteve transporti dhe pasurive të tjera - Mosndjekje e procedurave për debitorët dhe mosveprim ndaj zaptimeve të pronës publike - Likuidime për vendime gjyqësore pa nxjerrë përgjegjësi administrative	23	27
8	Bashkia Pustec	2025	- 22,486,478 lekë – nënvlerësim i llogarisë 470 (“të ardhura për t’u marrë”) për shkak të mungesës së pasqyrimit të saktë të llog. 468 - 2,196,820.39 lekë – mosshkarkim nga kontabiliteti i aktiveve të dëmtuara të nxjerra jashtë përdorimit	- Mospasqyrim i drejtë i aktiveve në kontabilitet (shkarkim, pakësime, nënvlerësime) - Gabime në paraqitjen e pasqyrave financiare (inventar, kapital, të ardhura)	17	19

			- 64,000 lekë – nënvlerësim i llog. 26 (“Aktive Afatgjata Financiare”) - 12,650 lekë – mbivlerësim i llog. 218 (“Inventar ekonomik”) për shkak të mosklasifikimit të saktë të librave si fond biblioteke	- Mungesë planifikimi buxhetor për transferimin e pronës publike te ASHK - Mospërgjigje në afat për rekomandimet e auditimit - Moszbatim i ligjit për menaxhimin e resurseve dhe potencialeve zhvillimore - Bllokim i llogarive të kreditorëve për mjete në ruajtje nga projekt-investime të vjetra		
9	Bashkia Kukës	2025	- 204,209,277.98 lekë – detyrime të papaguara nga bizneset për taksa dhe tarifa vendore - 24,572,657 lekë – taksa infrastrukture për legalizime e paarkëtuar - 1,215,236 lekë – detyrime të papaguara nga qiramarrës - 560,000 lekë – tarifë përkohshme për investime të paarkëtuar - 28,854,348 lekë – mospërputhje në vlerën e aktiveve në inventar - 257,135,966 lekë – aktive të kapitalizuara, të papërcaktuara në llogaritë përkatëse - 86,668,986 lekë – fatura të paevidentuara në llog. 467 - 28,128,366 lekë – detyrime të paanalizuara në llog. 468 - 13,545,856 lekë – investime të pashkarkuara në llog. 213	- Planifikim i pasaktë dhe mosrealizim i të ardhurave nga taksa/tarifa vendore - Mungesë dokumentacioni për ngarkesën e familjeve me taksa - Arkëtim i papërfillshëm për disa tarifa (parkim, veterinar, tregje) - Moszbatim i kontratave të qirasë për sipërfaqe pyjore/kullosore dhe mungesë kontratash për HEC/Karriere - Mosinventarizim dhe mosregjistrim i plotë i pasurive publike - Mospërputhje në llogaritë e bilancit për aktive dhe detyrime - Mungesë transferimi i AAGJM-ve te UK Kukës - Mangësi në procedura ligjore për dhënie me qira dhe mungesë dokumentacioni për kontrata afatgjata	21	24
10	Prefektura e Qarkut Tiranë	2025	- 13,342,000 lekë – vendime për ndihmë ekonomike në Kamëz në kundërshtim me VKM 597 - 11,842,828 lekë – këmbim i paligjshëm i detyrimit për taksë infrastrukture me apartamente - 3,349,000 lekë – miratim fondi emergjence pa bazë ligjore - 22,219,621 lekë – debi e papasqyruar për “Kinema Agimi” - 20,400,296 lekë – ndihmë emergjente në Tiranë pa dokumentacion të plotë	- Konfirmime të ligjshmërisë për akte që nuk janë normative - Vendime pa dokumentacion mbështetës ose jashtë kriterëve ligjore - Konfirmim vendimesh me efekte financiare pa vlerësim dëmi, rivlerësim të pajustificuar, mungesë transparence - Mungesë e ushtrimit të monitorimit dhe kontrollit nga sektori përkatës - Mosrespektim i afateve ligjore dhe tejkalim i kompetencave në vendimarrje	17	17

11	Bashkia Mirditë	2025	- 1,793,110 lekë – të ardhura të munguara nga mosvjelja e tarifës për hapësirën publike - 1,254,409 lekë – penalitete të paplikuara nga Drejtoria e të Ardhurave sipas legjislacionit - 4,690,000 lekë – të ardhura të munguara nga tarifimi jo sipas Paketës Fiskale për pastrimin - 576,821 lekë – penalitete të munguara për kontrata të porealizuara - 16,129,719 lekë – të ardhura të munguara nga mosmbledhja e detyrimeve të qirasë - 103,894,850 lekë – garanci punimesh me afat të kaluar, ende në - 6,284,216 lekë – vlera e pyjeve/ kullotave pa ndryshim nga viti i kaluar për shkak të mungesës së inventarizimit	- Mungesë inventarizimi dhe vlerësimi i pasurive si pyje, kullota, ndërtesa - Mospërputhje të gjendjes fizike dhe kontabël të aktiveve - Të ardhura të munguara nga zbatim jo i saktë i tarifave vendore - Mungesë penalitetesh të zbatuara sipas ligjit - Mosfunksionim i Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) - Mungesë plani strategjik 5-vjeçar zhvillimi për Bashkinë - Moszbatim i plotë i ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin - Mungesë dokumentacioni për garanci punimesh me afat të kaluar	17	18
12	Prefek-tura e Qarkut Elbasan	2025	Nuk është evidentuar dëm financiar i përlogaritur në shifra të sakta monetare	– Mungesë dokumentacioni pronësor dhe teknik për aktet e nxjerrjes jashtë përdorimit të pasurive publike (në Bashkinë Librazhd dhe Peqin); – Konfirmim vendimesh të këshillave bashkiakë pa certifikatë pronësie dhe vlerësim financiar për shpronësime; – Vendimmarrje e papërshtatshme gjatë fushatave zgjedhore, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor; – Mungesë dokumentacioni për fondet e emergjencave civile; – Shkelje të rregullave për konfirmimin e akteve normative nga prefekti.	14	14
13	Bashkia Selenic	2025	- 133,474,308 lekë – mosrealizim i buxhetit vjetor - 198,200 lekë – taksa të papaguara nga subjekte pa NIPT sekondar - 5,214,327 lekë – subjekt debitor pa asnjë kështë të paguar sipas marrëveshjes - 2,700,000 lekë – detyrim i paarkëtuar me marrëveshje të papërmblusur - 455,593,441 lekë – detyrime të pamblidhura tatimore deri më 31.12.2023 - 93,153 lekë – mosregjistrim i nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve - 9,057,580 lekë – nënvlerësim i llog. 24 “Aktive të dëmtuara”	– Mospërputhje mes planifikimit dhe realizimit buxhetor – Mungesë inspektimesh në terren dhe dokumentacioni për subjektet ekonomike – Mospërmblusje e marrëveshjeve për pagesën e detyrimeve tatimore – Moskontabilizim korrekt i debitorëve dhe kreditorëve në pasqyrat financiare – Detyrime të pamblidhura të konsiderueshme nga taksat dhe qiratë – Mungesë aktesh justifikuese për asgjësimin e aktiveve jashtë përdorimit	28	44
						35

			- 219,268,974 lekë – mosregjistrim i detyrimeve nga taksa/tarifa në llog. 468 - 530,578 lekë – nënvlerësim i llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” - 1,440,996 lekë – nënvlerësim i llog. 101 “Fondi i akumuluar” - 52,032,890.7 lekë – detyrime të pambledhura nga qiradhënia për tokë publike	– Mosrespektim i ligjit mbi sektorin minerar dhe mjedisin në përdorimin e pronës publike		
14	Bashkia Sarandë	2025	- 62,061,075 lekë – të ardhura të munguara nga mosveprim i njësisë së taksave dhe tarifave vendore - 22,142,400 lekë – efekt financiar negativ nga procedurat e prokurimit publik të shmangura ose të pa zbatuara - 9,928,993.36 lekë – dëm ekonomik nga punime të pa kryera - 17,315,695 lekë – shpenzime për aktivitete pa procedurë prokurimi	– Mungesë inventarizimi dhe pasqyrimi në kontabilitet i pasurive të paluajtshme (pyje/kullota, toka, ndërtesa) – Mungesë dokumentacioni dhe vonesa në dhënien e lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit – Shkelje të procedurave të prokurimit publik: kritere të gabuara, fitues me dokumentacion të paplotë, shmangie procedurash – Mungesë masash për debitorët dhe mosarkëtim të të ardhurave vendore – Mosrespektim i detyrimeve të IMTV: procese të paplota, mosndëshkim, gjoba të pabazuara, ndërtime pa masa ndëshkuese – Mospërputhje me rregullat kontabël për regjistrimin e aktiveve dhe detyrimeve – Shpenzime jashtë rregullave për aktivitete kulturore	56	67
15	Bashkia Pogradec	2025	- 255,682,000 lekë – të ardhura të munguara nga mosarkëtimi i taksave dhe tarifave vendore (143.8 mln lekë nga familjarët, 70.1 mln nga bizneset, 40.4 mln nga ndikimi në infrastrukturë, 1.3 mln nga tregtimi i karburanteve) - 20,025,232 lekë – rritje e debitorëve nga qiratë dhe të ardhura të tjera - 347,178,628 lekë – detyrime të prapambetura të pashlyera në fillim të vitit, nga të ardhurat e veta, pa grafik likuidimi - 146,099,377 lekë – vlerë e likuiduar pa planifikim paraprak - Mospërfshirje në llog. 468 e 184.3 mln lekëve detyrime të tjera (taksa + ndikimi në infrastrukturë) - Mospasqyrim i pjesëmarrjes reale të Bashkisë në kapitalin e UK Pogradec SHA (~36.1 mln lekë) në bilanc	– Të ardhura të munguara nga taksat vendore dhe ndikimi në infrastrukturë – Rritje e lartë e debitorëve dhe mosregjistrim i plotë në kontabilitet – Mospërfshirje e kapitalit aksionar të Bashkisë në Shoqërinë Rajonale të Ujësjellësit – Mospërgatitje dhe mospasqyrim i regjistrave kontabël analitikë për aktivet materiale – Mosregjistrim i pronave në ASHK; mungesë komisioni për verifikim dhe përditësim pronash – Mungesë pasqyrash të konsoliduara për 3 njësi vartëse – Probleme me llogaritë kontabël (202, 210–215, 26, 468) – Mungesë planifikimi për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura	21	21

Nr	Insti- tucioni i Audituar	Viti	Demi/Efekti Financiar (lekë) (i detajuar)	Fusha Kryesore e Problematikave (të detajuara)	Nr. Gjet- jeve	Nr. Re- koman- dimeve
1	Bashkia Roskovec	2024	- 4,739,122 lekë – dëm ekonomik nga punime të pakryera në projekte të ndryshme (rikonstruksion shkolle, asfaltime, ndërhyrje në fshatra) - 124,319,000 lekë – efekt negativ financiar nga prokurime të zhvilluara me shkelje procedurash ligjore - 206,087,743 lekë – të ardhura të munguara nga taksa/tarifa vendore (158.9 mln familjarë, 21 mln biznese, 26 mln nga ndikimi në infrastrukturë)	- Mospasqyrim real i aktiveve, si dhe i debitorëve dhe gjobave në llog. 468 - Mosregjistrim dhe mungesë inventarizimi i pasurive të paluajtshme - Procedura prokurimi me kritere të papërshtatshme dhe kualifikime të dyshimta - Mospasqyrim i servitutit dhe veprave publike nga projekti TAP-Mungesë regjistri të përditësuar të aktiveve materiale	25	28
2	Bashkia Shijak	2024	- 4,771,608 lekë – punime të pakryera ose jo sipas kontratës në projekte ndërtimi - 16,934,905 lekë – përlllogaritje e pasaktë e taksës së ndikimit në infrastrukturë - 1,517,400 lekë – përfitim i përsëritur për pajisje elektrike dhe hidraulike - 304,239 lekë – shpenzime karburanti pa dokumentacion justifikues - 2,185,000 lekë – efekt negativ nga kontrata të pajustificuara qiraje - 149,587,733 lekë – të ardhura të munguara nga taksa, tarifa, gjoba dhe licenca	- Shkelje në procedurat e prokurimit publik dhe në dokumentacionin mbështetës - Mangësi në miratimin e lejeve të ndërtimit dhe mungesë plani vendor - Mospërlllogaritje e saktë e TNI dhe mungesë certifikatash përdorimi - Të ardhura të pambledhura nga debitorë të biznesit, familjarë, institucione, dhe subjekte pa licencë - Mospasqyrim në kontabilitet i 54 pronave dhe mosregjistrim në ASHK i pasurive publike	28	29
3	Bashkia Malësi e Madhe	2024	- 5,698,374 lekë – dëm ekonomik nga punime të pakryera në 7 raste - 344,475,253 lekë – kontrata të lidhura me operatorë që nuk plotësojnë kriteret - 106,824,471 lekë – detyrime të papaguara nga biznese dhe familjarë - 20,263,481 lekë – detyrime takse infrastrukturë të papaguara - 10,617,581 lekë – debitorë të pa kontabilizuar	- Zbatimi i kontratave të punimeve ndërtimore me defekte - Procedurat e prokurimit publik jo në përputhje me ligjin - Mangësi në planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave tatimore - Mospërditësim dhe pasqyrim i pasaktë i aktiveve në kontabilitet - Moszbatim i ligjit për menaxhimin e pronave dhe fondeve publike	33	33
4	Bashkia Fushë Arrëz	2024	- 28,439,000 lekë – të ardhura të munguara nga mosarkëtimi i taksave dhe tarifave vendore - 9,194,316 lekë – pasqyrim i tepruar i llogarisë “Kreditorë për mjete nën ruajtje” pa dokumentacion për likuidim - Vlera e papasqyruar e 394 pronave pyjore dhe kullotash me sipërfaqe	- Mangësi në inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve të paluajtshme, përfshirë mos miratimin e listës përfundimtare të pasurive dhe mosarkordimin me ASHK - Mosarkëtim i taksave dhe tarifave vendore nga debitorë të ndryshëm	12	12
						37

			65,287,847 m ² (vlerë nënvlerësim në llogarinë 211)	- Pasqyrim jo korrekt i llogarive financiare (kreditorë dhe asete pyjore) - Procedura të dobëta për menaxhimin e aseteve dhe garancive financiare		
5	Bashkia Divjakë	2024	- 552,971,435 lekë – detyrime tatim-taksa vendore të papaguara - 32,407,000 lekë – detyrime të prapambetura progresive - 5,175,262 lekë – fonde të ngurtësuara nga garancitë kontraktuale - 21,049,578 lekë – nënvlerësim në llogarinë 7206 “Financim i pritshëm” - 5,846,966 lekë – nënvlerësim investimesh të kontabilizuara gabim - 389,620,451 lekë – nënvlerësim në llogarinë 401-408 për faturat tatimore investimesh - 2,553,672 lekë – mbivlerësim në llogarinë 210 - 2,041,769 lekë – mbivlerësim në llogarinë 211 - 3,293,294 lekë – mbivlerësim në llogarinë 212	- Mangësi në planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të ardhurave - Detyrime të mëdha të papaguara nga tatimpaguesit familjarë e bizneset - Probleme në kontabilizimin dhe klasifikimin e aktiveve financiare dhe aseteve fizike - Fonde të ngurtësuara të garancive kontraktuale pa pastruar - Mos sistemim i regjistrave dhe mungesë e masave për arkëtimin e detyrimeve - Mungesë inventarizimi dhe verifikimi të aktiveve të tokës, pyjeve dhe ndërtesave - Nēnvlerësime dhe mbivlerësime në llogaritë financiare të Opasqyrave	18	20
6	Bashkia Bulqizë	2024	- 42,132,697 lekë – të ardhura të munguara nga taksa dhe tarifa vendore (3,577,360 lekë taksa vendore, 5,800,000 lekë tarifa licensimi hidrokarburesh, 1,273,024 lekë taksa infrastrukturë, 31,482,313 lekë qiradhënie pyje, kullotash) - 7,078,000 lekë – detyrime të prapambetura pa shlyer - 4,865,108 lekë – studime dhe kërkime të pa analizuar dhe pa informacion për zbatim - 225,599,068 lekë – vlera e ujës-jellës-kanalizimeve të transferuara - 7,771,619 lekë – mbivlerësim në llogarinë 401-408 “Furnitorë” - 452,864 lekë dhe 4,441,818 lekë – diferenca në llogaritë 31 dhe 32 (materiale dhe inventar i imët) - 267,179 lekë – nënvlerësim në llogarinë 210 për shkak amortizimi të gabuar - 200,483,667 lekë – amortizim i nënvlerësuar - 11,955,591 lekë – aktive të dëmtuara jashtë përdorimit	- Mungesë inventarizimi dhe dokumentacioni teknik për asetet fizike dhe pronësinë - Mangësi në regjistrimin e detyrimeve dhe shlyerjen e tyre - Nēnvlerësim dhe mbivlerësim të llogarive kontabël, veçanërisht për aktive dhe amortizim - Mungesë njohjeje dhe kontabilizimi të të ardhurave të pritshme nga taksat dhe tarifat vendore - Moskryerja e inventarizimit dhe verifikimit për vitin 2023 - Pasaktësi në klasifikimin dhe evidentimin e aktiveve të ujës-jellës-kanalizimeve dhe aktiveve të dëmtuara - Mungesë masa për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe tarifore - Mbivlerësim në disa llogari kontabël dhe mungesë sistemimi të duhur financiar	19	19

6	Bashkia Bulqizë	2024	- 42,132,697 lekë – të ardhura të munguara nga taksa dhe tarifa vendore (3,577,360 lekë taksa vendore, 5,800,000 lekë tarifa licensimi hidrokarburesh, 1,273,024 lekë taksa infrastrukturë, 31,482,313 lekë qiradhënie pyje, kullotash) - 7,078,000 lekë – detyrime të prapambetura pa shlyer - 4,865,108 lekë – studime dhe kërkime të pa analizuar dhe pa informacion për zbatim - 225,599,068 lekë – vlera e ujës-jellës-kanalizimeve të transferuara - 7,771,619 lekë – mbivlerësim në llogarinë 401-408 “Furnitorë” - 452,864 lekë dhe 4,441,818 lekë – diferenca në llogaritë 31 dhe 32 (materiale dhe inventar i imët) - 267,179 lekë – nënvlerësim në llogarinë 210 për shkak amortizimi të gabuar - 200,483,667 lekë – amortizim i nënvlerësuar - 11,955,591 lekë – aktive të dëmtuara jashtë përdorimit	- Mungesë inventarizimi dhe dokumentacioni teknik për asetet fizike dhe pronësinë - Mangësi në regjistrimin e detyrimeve dhe shlyerjen e tyre - Nēnvlerësim dhe mbivlerësim të llogarive kontabël, veçanërisht për aktive dhe amortizim - Mungesë njohjeje dhe kontabilizimi të të ardhurave të pritshme nga taksat dhe tarifat vendore - Moskryerja e inventarizimit dhe verifikimit për vitin 2023 - Pasaktësi në klasifikimin dhe evidentimin e aktiveve të ujës-jellës-kanalizimeve dhe aktiveve të dëmtuara - Mungesë masa për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe tarife - Mbivlerësim në disa llogari kontabël dhe mungesë sistemimi të duhur financiar	19	19
7	Bashkia Mat	2024	- 40,671,223 lekë – detyrime të prapambetura për tatim-taksa vendore - 30,242,573 lekë – efekt negativ nga administrimi i fondeve publike - 63,443,327 lekë – efekte negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore - 29,073,330 lekë – detyrime të prapambetura në 36 raste (fatura mallrash, shërbimesh, investimesh, vendime gjyqësore) - 50,486,470 lekë – nënvlerësim i debitorëve të ndryshëm (abonentë familjarë) - 22,942,342 lekë – mbivlerësim llogaria 210 (toka, troje, terrene) për shkak regjistrimi të pasaktë në llogari - 550,100,013 lekë – mbivlerësim në llogarinë 101 “Teprica”	- Mungesë bashkëpunimi me ASHK dhe DRSHTRR për rakordim të të dhënave - Pa përcaktuar person përgjegjës për ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë - Detyrime të prapambetura të larta dhe pa menaxhim efektiv - Mos hartim i pasqyrave financiare të konsoliduara për ndërmarrjet varësie - Mangësi në evidencën dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore - Pasaktësi në kontabilizim dhe regjistrim të aktiveve dhe detyrimeve - Mungesë inventarizimi dhe verifikimi i aktiveve në llogari kontabël - Mbivlerësime dhe nënvlerësime në llogaritë financiare kryesore	19	21
8	Bashkia Devoll	2024	58,553,000 lekë të ardhura të munguara nga taksa, tarifa dhe kontrata qiraje - 94,936,727 lekë vlera e pa analizuar në llogarinë 212 “Ndërtime konstruksione”	- Mangësi në procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave - Mos arkëtim i taksave dhe tarifave vendore nga bizneset, familjarët dhe institucionet	16	18
						39

			- 572,125,235 lekë vlera e pa analizuar në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” - 7,762,000 lekë nënvlerësim në llogarinë 26 “Pjesmarrje në kapitalet e veta” - Mospërfshirje e 58,553,508 lekë në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” - Mospasqyrim në inventar dhe kontabilitet i 2,987 pasurive (1,403 në pronësi dhe 1,596 në përdorim) - Mbivlerësim i llogarisë 202 për 15,409,520 lekë (3 projekte të përfshira gabimisht)	- Mos regjistrim dhe inventarizim i pasurive në pronësi dhe përdorim - Nuk është ngritur grup pune për dokumentacion teknik dhe regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) - Nuk ka bashkëpunim dhe rakordim me ZVRPP Korçë - Gabime në kontabilizim dhe klasifikim të projekteve, investimeve dhe aktiveve afatgjata - Pasaktësi në regjistrimin e detyrimeve dhe debitorëve në kontabilitet - Pa analiza dhe emërtime për disa llogari kryesore të aktiveve		
9	Prefektura e Qarkut Shkodër	2024	Nuk specifikohet efekt financiar i saktë monetar	- Procedura të mangëta e formale në prokurime “blerje me vlerë të vogël” (copëzim fondesh, mungesë kriteresh, mungesë shpalljes fituese, mungesë dokumentacioni argumentues) - Mungesë veprimi për 43 VKB të pa konfirmuara nga Prefekti - Akte normative me dokumentacion të mangët, procese votimi të parregullta - Dhënie pronash pa certifikatë pronësie dhe pa plan vendosje sipërfaqesh - Miratime vendimesh pa konsultim publik në disa raste - Vendim i ligjshëm për dëmshpërblim me sipërfaqe të ndryshme nga pronësia - Dhënie për përdorim të pasurive publike gjatë fushatave zgjedhore	9	10
10	Bashkia Delvinë	2024	- 68,016,000, të ardhura të munguara nga taksat dhe tarifatat vendore - 807,000, të ardhura të munguara nga taksa ndikimit infrastrukturë	- Mos arkëtim taksash dhe tarifash vendore (68,016,000 lekë) - Mos arkëtim taksës ndikimit në infrastrukturë (807,000 lekë) - Mangësi në procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave - Inventarizimi dhe regjistrimi i aseteve publike (664 prona) - Nënvlërësim/mbivlerësim në llogari kontabël për aktive afatgjata dhe mjete transporti	10	10

11	Bashkia Përmet	2024	- 46,072,270 lekë – të ardhura të munguara nga detyrimet tatimore të paguara nga abonentë familjarë, biznese dhe institucione - 30,119,149 lekë – detyrime të prapambetura - 12,554,125 lekë – efekt negativ nga zbatimi i vendimeve gjyqësore - 1,000,000 lekë – shpenzime të kryera pa procedura prokurimi për projekte artistike - 2,703,510 lekë – nënvlerësim i llogarisë “Teprica e akumuluar” - Mungesë pasqyrimi i vlerave të pasaktësuara të aktiveve në llogaritë 202, 210, 212, 213 (shuma e përgjithshme jo e saktësuar në raport, por e konsiderueshme)	- Sistemi jo efektiv i kontrollit të brendshëm financiar - Mungesë planifikimi dhe parashikimi i buxhetit vjetor - Mospërputhje në raportime financiare dhe kontabilitet - Administrim i mangët i të ardhurave vendore dhe mungesë akt-rakordimesh me agjentët tatimorë - Mungesë sistemi për menaxhimin e taksave dhe tarifave - Regjistrim i pasaktë dhe joanalitik i aktiveve (tokë, ndërtesa, rrugë, inventar) - Mosregjistrim dhe mungesë dokumentacioni për pronat publike të transferuara - Mungesë e gjurmës së auditimit në shumë procese - Mungesë strukturash dhe kapacitetesh në auditimin e brendshëm	27	34
12	Bashkia Libohovë	2024	- 27,870,634 lekë të ardhura të munguara (nga familjarë, biznese, fermerë, taksë infrastrukture dhe qira tokash/pyjesh) - 742,167 lekë “Vlerë tjetër” pa dokumentacion në llogarinë 214 - 14,265,168 lekë mallra të pakontabilizuara në llogarinë 214 - Vlera të paidentifikuara në llogaritë e aktiveve (202, 212, 213, 214) në total 19,372,484 lekë - Mungesë amortizimi për disa pasuri - Mosllogaritje e amortizimit për rrugën 29 km me VKM nr. 915	- Mungesë efektiviteti në mbledhjen e të ardhurave vendore - Mungesë pasqyrimi i saktë i aktiveve në regjistrat kontabël - Mungesë dokumentacioni mbështetës për vlerat e deklaruara - Mosrespektim i standardeve të kontabilitetit dhe përpunimit financiar - Mungesë e gjurmës së auditimit dhe kontrolleve të brendshme - Mangësi në strukturën dhe trajnimin e burimeve njerëzore - Mospërfshirje e pasurive të paluajtshme të transferuara nga shteti në pasqyrat financiare	18	22
13	Bashkia Pukë	2024	- 14,206,471 lekë të ardhura të munguara nga mosarkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorë biznesi - 802,148 lekë nga mosarkëtimi i taksës së nga debitorë familje - 2,746,417 lekë nga mosarkëtimi i taksës së tokës nga fermerët debitorë - 1,451,532 lekë nga mosarkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë - 6,240,200 lekë nga mosarkëtimi i tarifës së qirasë - 30,633,989 lekëDiferenca në llog. “Të tjera Operacione me shtetin (të drejta)”	- Mosarkëtim i detyrimeve tatimore dhe tarifave vendore - Mungesë kontrolli dhe dokumentimi adekuat për aktive dhe investime - Pasqyrim i pasaktë i bilancit financiar - Mospërputhje midis regjistrave kontabël dhe analizave fizike - Mungesë efektiviteti në menaxhimin e borxhit tatimor - Mangësi në proceset e inventarizimit dhe kontrollit të brendshëm - Probleme në menaxhimin dhe kontrollin e kontratave dhe pagesave	22	25

			- Kapitalizim i paqartë i investimeve (p.sh. Ujsjellësi Gjegjanit, 85,000,000 lekë) - Mospërputhje e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” (nënvlerësim 7,285,873 lekë) - Investime të klasifikuara gabim si shpenzime në proces (73,804,717 lekë)	-		
14	Bashkia Kurbin	2024	- 383,751,000 lekë (borxh tatimor i pa arkëtuar në taksa dhe tarifa vendore) - 57,405,000 lekë (të ardhura të pa arkëtuara nga taksat dhe tarifat e bizneseve dhe institucioneve) - 65,686,000 lekë (të ardhura të pa arkëtuara nga taksa familjare) - 131,152,000 lekë (të ardhura të pa arkëtuara nga taksa e tokës nga fermerët) - 50,742,000 lekë (të ardhura të pa arkëtuara nga taksa ndikimit në infrastrukturë) - 13,820 lekë (shpenzime për punë të pakryera të pastrimit)	- Mangësi në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore - Mangësi dokumentare në shpenzimet për pastrim, gjelbërim dhe mirëmbajtje varrezash - Regjistrim i pjesshëm i pronave të paluajtshme në kontabilitet - Mungesë certifikatash pronësie për prona dhe pyje - Mungesë plane dhe verifikime për menaxhimin e fondit pyjor - Problem në menaxhimin e borxheve tatimore dhe taksave familjare - Shpenzime të pakontrolluara për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe varrezave	17	19
15	Prefektura e Qarkut Vlorë	2024	- Nuk specifikohet dëmi financiar në shifra të sakta në raport. - Materialiteti i auditimit: 1,185,000 lekë mbi shpenzimet faktike 2023	- Mungesë strategjie dhe regjistrit të menaxhimit të riskut për sektorët e institucionit (vetëm financa dhe shërbimet e brendshme kanë regjistër risku). - Mungesë raportesh periodike dhe vjetore për bashkërendimin e veprimtarisë Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile. - Mungesë personi përgjegjës për menaxhimin e prokurimeve; caktim i nëpunësve me konflikte interesi në komisionet e prokurimit. - Procedura prokurimi të copëzuara dhe pa shpallje në APP për vlera të vogla; mungesë deklaratash mbi konfliktin e interesit. - Konfirmime të vendimeve të Këshillave Bashkiakë me probleme ligjore dhe pa dokumentacion adekuat. - Mungesë regjistri shkresor apo elektronik të aktivitetit të Prefektit për verifikimin e ligjshmërisë së akteve.	13	13

16	Bashkitë Librazhd, Krujë, Berat, Skrapar (auditim tematik)	2024	- 2,206,200 lekë mungesë të ardhurash nga detyrimet për qira shfrytëzimi të fondit pyjor dhe kullor) - 115,544,560 lekë arkëtim i paplotë i debitorëve në bashki)	- Pasqyrimi jo i saktë i llogarive në pasqyrat financiare - Llogaritë inventariale nuk janë krahasuar me inventarin fizik - Nënvlërësime, moskuadrime llogarish - Mungesë titujsh pronësie për objekte inventari të pasurive të paluajtshme - Gabime kontabel	9	9
17	Bashkia Belsh	2024	- 89,566,543 lekë (të ardhura të munguara nga taksat dhe tarifave vendore: 8,890,013 lekë nga debitorë biznesi, 80,676,530 lekë nga debitorë familjarë) - 7,700,000 lekë (debitorë nga tregtimi i karburanteve) - 1,099,220 lekë (të ardhura të munguara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për leje legalizimi) - 2,184,688 lekë (të ardhura të munguara nga detyrimet për shfrytëzim sipërfaqesh pyjore) - 15,252,450 lekë (vendime gjyqësore të palikuiduara, të papasqyruara në pasqyrat financiare) - 38,000 lekë (mbivlerësim i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”)	- Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave - Mosarkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorë biznesi dhe familjarë - Debitorë nga tregtimi i karburanteve - Mosarkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë - Mangësi në kontabilizimin e vendimeve gjyqësore - Gabime në amortizimin e aktiveve afatgjata materiale - Pasqyra jo reale e pasurive të paluajtshme dhe mungesë titujsh pronësie - Probleme në inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve	14	14
18	Bashkia Tepelenë	2024	- 33,874,193 lekë (detyrime të prapambetura) - 6,535,790 lekë (efekte financiare negative/të ardhura të munguara) - 40,728,488 lekë (detyrime për arkëtim nga taksa dhe tarifa vendore) - 2,785,790 lekë (vlera e pa derdhur nga Ujësjiellës-Kanalizime e taksave dhe tarifave vendore) - 352,003 lekë (amortizim i pa llogaritur për projektin “Studim, mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane”) - 43,646,548 lekë (pagesa jashtë afatit të faturave për mallra, shërbime dhe investime)	- Nivel i lartë i detyrimeve të prapambetura dhe mos realizim të të ardhurave - Mos pasqyrim real i situatës në llogaritë kontabël - Mospërlllogaritje e amortizimit të aseteve jo materiale - Mangësi në regjistrimin dhe certifikimin e aseteve (veçanërisht objekteve) - Pagesa jashtë afateve të miratuara - Mungesë e regjistrave të plota për taksapaguesit familjarë - Vonesa dhe mos arkëtim i detyrimeve tatimore dhe tarifave vendore	13	13
19	Bashkia Peqin	2024	- 14,372,078 lekë (debitorë biznesi nga taksat dhe tarifave vendore) - 22,579,200 lekë (debitorë familjarë për taksën e tokës, taksë ndërtese dhe tarifa vendore) - 6,151,138 lekë (të ardhura të munguara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për leje legalizimi)	- Mangësi në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave - Mos arkëtim i taksave dhe tarifave vendore nga subjekte biznesi dhe familjare - Mungesë e inventarit fizik për aktive afatgjata materiale	19	19
						43

			- 538,208 lekë (detyrime të papaguara për kontrata shfrytëzimi sipërfaqe pyjore) - 36,951,278 lekë (borxh tatimor i papaguar) - 589,691,927 lekë (vlera e artikujve të inventarit të transferuar në Ujësjetllës Kanalizime)	- Mos kontabilizim i detyrimeve të papaguara për taksën e ndikimit në infrastrukturë - Pasqyrimi jo i saktë i inventarit të transferuar në shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime - Mungesë e regjistrave të pronave të paluajtshme të ish-komunave - Nevoja për masa administrative dhe ligjore për arkëtim dhe likuidim detyrimesh		
20	Bashkia Kolonjë	2024	- 24,782,000 lekë (dëme nga punime të pakryera në 4 projekte ndërtimi) - 79,424,000 lekë (të ardhura të munguara nga mos arkëtimi taksash dhe tarifash vendore) - 759,000 lekë (të ardhura të munguara taksë ndikimi infrastrukturë nga 31 persona) - Vlera e pasaktësive në llogaritë kontabël mbi 100 mln lekë (mbivlerësime/nënvlerësime në disa llogari kryesore)	- Zbatimi i kontratave të punimeve me dëm ekonomik nga punime të pakryera - Procedurat e prokurimit me mosrespektim të kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike - Dokumentacion i paplotë për lejet e ndërtimit dhe mungesë e inspektimeve efektive - Mangësi në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave - Sistemi joefektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm - Mos arkëtim i detyrimeve të prapambetura dhe borxheve tatimore	29	31
21	Bashkia Finiq	2024	- 58,338,926 lekë (të ardhura të munguara nga taksat dhe tarifatat) - 31,995,678 lekë (pagesa jashtë afatit ligjor) - 17,467,104 lekë (fonde të ngurtësuar për objekte të përfunduara) - 23,056,648 lekë (pagesa për investime të pakryera) - 3,369,024 lekë (mbivlerësim në llogari të pasaktë) - 200,267,000 lekë (të ardhura për arkëtim në proces)	- Mungesë e zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm - Probleme në menaxhimin financiar dhe auditimin e brendshëm - Borxh tatimor i lartë dhe performancë e dobët në arkëtim - Mungesa në dokumentacionin e bizneseve dhe detyrimeve - Probleme me inventarizimin dhe pasqyrat financiare - Zbatim i dobët i rekomandimeve të mëparshme	15	23
